



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike
Ministarstvo Unutrašnjih Poslova i Javne Uprave
Ministry of Internal Affairs and Public Administration
Inspektorati Policor i Kosovës
Policijski Inspektorat Kosova / Police Inspectorate of Kosovo



RAPORT VJETOR



2019

Inspektorati Policor i Kosovës

© Të drejtat e autorit të Inspektoratit Policor të Kosovës

Teksti i këtij dokumenti mund të riprodhohet falas në çdo format ose medium, me kusht që të riprodhohet me saktësi dhe jo në një kontekst mashtrimi.

Ky material duhet të njihet si e drejtë e autorit (Inspektoratit Policor të Kosovës) dhe dokumenti si titulli i specifikuar.

Kur është identifikuar materiali nga pala e tretë, leja nga mbajtësi i të drejtës së autorit duhet të kërkohet.

Çdo pyetje në lidhje me këtë publikim duhet të na dërgohet në:

Inspektorati Policor i Kosovës,

Rruga “Dëshmorët e Gollakut”, p.n, Hajvali, Prishtinë,

Tel: 038 200 19 691, +383 (0)38 521 201

E-mail: info.ipk@rks-gov.net



Inspektorati Policor i Kosovës
Ministria e Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike

Z. Agim Veliu
Ministër
Ministria e Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike

12 Mars 2020

I nderuar z. Ministër,

Kam kënaqësinë t'iu paraqesim Raportin Vjetor të Punës së Inspektoratit Policor të Kosovës, i cili mbulon periudhën nga 1 Janar deri më 31 Dhjetor 2019. Ky Raport është paraqitur në përputhje me nenin 10 të Ligjit nr. 03/L-231 për Inspektoratin Policor të Kosovës.

Me respekt,

Miradije Kelmendi
Kryeshefe Ekzekutive,
Inspektorati Policor i Kosovës

SHKURTESAT

AKSP	Akademia e Kosovës për Siguri Publike
BQK	Banka Qendrore e Kosovës
DFSHP	Departamenti i Financave dhe Shërbimeve të Përgjithshme
DH	Departamenti i Hetimeve (IPK)
DI	Departamenti i Inspektimeve
DIA	Drejtoria për Inteligjencë dhe Analizë
DMA	Departamenti për Menaxhimin e Ankesave
DMH	Drejtoria për Migrim dhe të Huaj
DMO	Drejtoria për Menaxhimin e Objekteve
DPP	Drejtoria e Përgjithshme e Policisë
DRP	Drejtoria Rajonale e Policisë
DRK	Drejtoria Rajonale Kufitare
DKRR	Divizioni i Komunikacionit Rrugor
DSP	Divizioni i Standardeve Profesionale
DSHAM	Departamenti për Shtetësi, Azil dhe Migrim
EVSB	Ekipi Veprues për Siguri në Bashkësi
FRONTEX	The European Border and Coast Guard Agency
ICITAP	Internacional Criminal Investigative Training Assistance Program
IPK	Inspektorati Policor i Kosovës
IKAP	Instituti i Kosovës për Administratë Publike
KKSB	Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi
MFK	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli
MIK	Menaxhimi i Integruar i Kufirit
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
MPJ	Ministria e Punëve të Jashtme
NERCISU	Network for Enhanced Regional Cooperation of Internal Security Units
NJKA	Njësia e Kontrollit të Autostradës
NJRKRR	Njësia Rajonale e Komunikacionit Rrugor
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
PK	Policia e Kosovës
PSO	Procedura Standarde e Operimit
SIPK	Sistemi Informativ i Policisë së Kosovës
SPK	Stacioni Policor Kufitar
SPMK	Stacioni Policor për Mbikëqyrje të Kufirit
SHBK	Shoqata e Bankave të Kosovës
TI	Teknologjia Informative
UNMIK	United Nations Interim Administration Mission in Kosovo

PËRMBAJTJA

1.	RRETH NESH	6-6
2.	FJALA E KRYESHEFES EKZEKUTIVE	7-7
3.	HYRJE.....	8-8
4.	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	9-9
5.	MENAXHIMI I ANKESAVE	11-15
6.	HETIMET PENALE	17-25
7.	INSPEKTIMET E STRUKTURAVE DHE FUNKSIONEVE POLICORE.....	27-40
8.	MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN, PROMOVIMI DHE BASHKËPUNIMI	41-46
9.	SHËRBIMET FINANCIARE, ADMINISTRATIVE DHE MBËSHTETËSE.....	47-50

1. RRETH NESH

Historik i shkurtër

IPK është mekanizëm i pavarur mbikëqyrës, i ndarë nga Policia e Kosovës dhe funksionon sipas modelit të vendeve perëndimore që aplikojnë standarde të larta ndërkombëtare të kontrollit policor dhe respektimit të të drejtave të njeriut. Është themeluar në korrik të vitit 2006 në bazë të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2005/54 dhe Urdhresës Administrative nr. 2006/9, si Agjencion Ekzekutiv në kuadër të MPB-së. Bazuar në këto akte, ka funksionuar deri me hyrjen në fuqi të Ligjit nr. 03/L-136 për IPK-në, të miratuar në vitin 2008. Më pas, për shkak të ndryshimit të mandatit ligjor në fushën e hetimeve, nga viti 2010, IPK-ja funksionon bazuar në Ligjin nr. 03/L-231, i cili ka hyrë në fuqi më 1 Dhjetor 2010.

Fushëveprimi

Objekt i veprimtarisë së IPK-së është:

1. Parandalimi, zbulimi, dokumentimi dhe hetimi i veprave penale të kryera nga punonjësit e Policisë së Kosovës, pa dallim grade dhe pozite gjatë ushtrimit të detyrës ose jashtë saj;
2. Inspektimi i strukturave dhe funksioneve të Policisë së Kosovës, për të siguruar llogaridhënie, efektivitet dhe efikasitet në zbatueshmërinë e ligjeve, akteve nënligjore dhe procedurave standarde të operimit në fuqi;
3. Hetimi dhe/ose inspektimi i incidenteve disiplinore të profilit të lartë, ku përfshihen të gjithë punonjësit policor me gradën më të lartë të nivelit të lartë të menaxhimit dhe zyrtarëve policor të nivelit të lartë ekzekutiv;
4. Kur ekziston dyshimi i bazuar se Drejtori i Përgjithshëm i Policisë ka kryer shkelje

disiplinore, Kryeministri mund të autorizon Inspektoratin Policor të Kosovës për zhvillim të hetimeve disiplinore. Inspektorati Policor i Kosovës pas përfundimit të hetimeve disiplinore i raporton Kryeministrit për të gjeturat;

5. Pranimi i të gjitha ankesave të qytetarëve, si dhe shqyrtimi dhe përcaktimi se cilat nga ankesat hetohen nga Inspektorati Policor i Kosovës dhe cilat do t'i referohen Policisë së Kosovës apo institucioneve përgjegjëse

Misioni

Misioni i IPK-së është që përmes ushtrimit të veprimtarisë së tij, të sigurojë një shërbim policor të përgjegjshëm, demokratik dhe transparent, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe standardet e kërkuara.

Vizioni

IPK synon fuqizimin e rolit të tij në funksion të rritjes së integritetit, profesionalizmit dhe ofrimit të shërbimeve profesionale dhe etike për qytetarët.

Parimet tona

Si një agjenci e përkushtuar për t'iu shërbyer interesave të të gjithë qytetarëve, IPK-ja udhëhiqet nga vlerat, si: përgjegjshmëria, profesionalizmi, objektiviteti, paanshmëria, mosdiskriminimi, transparenca, efikasiteti dhe efektiviteti.

2. FJALA E KRYESHEFES EKZEKUTIVE

Të nderuar lexues,

Kam nderin dhe kënaqësinë që t'iu prezantoj rezultatet dhe të arriturat e punës së IPK-së për vitin 2019. Edhe gjatë këtij viti në të gjitha nivelet organizative të IPK-së është punuar në ngritjen e efikasitetit dhe profesionalizmit në përmbushjen e misionit dhe autorizimeve ligjore, në funksion të mbikëqyrjes së punës policore.



I tërë angazhimi në përmbushjen e misionit për të kontribuar në zhvillimin e një policie demokratike, profesionale dhe të përgjegjshme, ka ngritur në vazhdimësi përkrahjen dhe besimin e qytetarëve tek ne. Këtë e dëshmon ngritja e numrit të ankesave që paraqiten në mënyrë të vazhdueshme në IPK. Trajtimi serioz, si dhe hetimi profesional i këtyre ankesave, ka bërë që rezultatet tona në luftimin e keqpërdorimeve në radhët e Policisë të jenë evidente, duke përfshirë këtu raste të shumta të arrestimeve për keqpërdorim të detyrës dhe korrupsion.

Realizimi i inspektiveve të rregullta dhe të jashtëzakonshme edhe këtë vit ka pasqyruar mënyrën e kryerjes së detyrave policore, duke identifikuar edhe dobësi evidente, për të cilat janë dhënë rekomandime për ngritjen e performancës, efikasitetit dhe mënyrën e adresimit të zgjidhjes së problemeve brenda strukturës dhe funksioneve të caktuara të Policisë.

IPK-ja ka arritur që gjatë vitit 2019 të konsolidojë partneritetin me partnerët vendorë dhe ndërkombëtarë, duke bashkëpunuar ngushtë më Prokurorinë e Shtetit, Avokatin e Popullit, institucionet dhe organizatat që kontribuojnë në fuqizimin e sundimit të ligjit në Kosovë.

Kemi arritur që të jemi pjesë e nismave dhe konferencave rajonale dhe ndërkombëtare, përvoja këto që kanë rritë profesionalizmin e punonjësve tanë. Edhe këtë vit, IPK-ja në vazhdimësi është përkrahur nga partnerët ndërkombëtarë, ku duhet veçuar ICITAP-in, OSBE-në, Këshillin e Evropës, etj. Kjo përkrahje e partnerëve ka qenë kryesisht e lidhur me ngritjen e kapaciteteve tona profesionale dhe teknike. Ky partneritet vazhdon edhe më tutje dhe na siguron ngritjen e profesionalizmit dhe rolit tonë në fuqizimin e sundimit të ligjit në Kosovë.

Së bashku me partnerët tanë, IPK-ja do të angazhohet tutje që ta ruaj dhe fuqizoj edhe më shumë besimin tek qytetarët. Ruajtja e këtij besimi do të realizohet duke siguruar punë profesionale dhe cilësore, konfidencialitet gjatë trajtimit të informacioneve, nivel të lartë të integritetit, vlera morale të punonjësve, si dhe shtrirje të shërbimit sa më afër qytetarëve.

Në fund, më lejoni t'iu rikujtoj se të dhënat e prezantuara në këtë Raport, të arriturat dhe indikatorët e tjerë të suksesit, janë rezultat i përkushtimit të të gjithë punonjësve të IPK-së, të cilët i falënderoj, duke iu siguruar mbështetjen time të vazhdueshme, drejt ngritjes së nivelit të zhvillimit institucional, profesional dhe fuqizimit të mirëqenies së tyre.

3. HYRJE

Ky është Raport përmbledhës i punës së IPK-së për periudhën Janar - Dhjetor 2019, i cili përmban aktivitete dhe të arritura të dokumentuara. Raporti i këtij viti pasqyron sfidat dhe aktivitetet e ndërmarra bazuar në kompetencat e parapara me legjislacionin në fuqi dhe të arriturat kryesore gjatë kësaj periudhe.

Në drejtim të ngritjes së transparencës dhe ofrimit të informacionit për qytetarëve mbi punën që bëjmë, IPK-ja për të katërbëdhjetën herë me radhë praktikon që të publikojë një dokument përmbledhës në standardin e një Raporti të rregullt vjetor, ku pasqyrohen sfidat dhe angazhimet tona në përmbushje të përgjegjësive dhe misionit ligjor.

IPK vlerëson se nga viti në vit puna jonë vazhdon të jetë më cilësore dhe këtë e dëshmojnë rezultatet tejet mbresëlënëse. Rezultatet konsiderohen se janë të përbashkëta, ngase pjesë të suksesit tonë bartin dhe qytetarët që ofruan një bashkëpunim në denoncimin e shkeljeve nga radhët policore, por edhe partnerët tanë që na mbështetën në këtë rrugëtim.

Përgjegjësitë dhe detyrat që lidhen me funksionet e saj, IPK i ka të ndara në departamente. Bazuar në Rregulloren (MPB) nr. 01/2017 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës për punonjësit e IPK-së, agjencia jonë është e strukturuar në pesë (5) departamente, prej të cilave, katër (4) janë operative dhe një (1) mbështetës. Roli i secilit departament është i shtjelluar në brendësi të këtij Raporti.

Raporti i këtij viti është i ndarë në disa kapituj, ku pasqyrohen aktivitetet e departamenteve, rezultatet e punës dhe sfidat në arritjen e rezultateve. Vlerësohet të ketë pasur një ngritje të cilësisë në punë, ngase këtë vit në kuadër të strukturës operative është ngritur kapaciteti hetimor me një gjeneratë punonjësish, të cilët kanë përfunduar me sukses fazën e trajnimit fushor.

Vitin që lamë pas në agjencinë tonë është kryer një vlerësim nga mekanizma ndërkombëtar për të verifikuar profesionalizmin dhe performancën e agjencisë në përmbushjen e misionit ligjor, po edhe në kryerjen e detyrave në frymën e ligjit në fuqi. Rezultatet e këtij hulumtimi kanë rezultuar pozitiv, duke vënë theks të veçantë cilësinë e angazhimeve dhe kapacitetet që ka agjencia.

IPK-ja do të vazhdojë të jetë e përkushtuar në ngritjen e cilësisë së shërbimit, në përmbushje të mandateve që dalin nga Ligji për IPK-në, në drejtim të sigurimit që Policia e vendit tonë të zhvillohet si forcë e përgjegjshme, profesionale dhe demokratike. Ky mision konsiderohet i rëndësishëm për ne, andaj dhe interesi ynë është që Policia të zhvillohet krahas standardeve ndërkombëtare.

Në përfundim të kësaj hyrjeje, vlerësojmë se edhe pse kemi ofruar disa dritare të informimit të qytetarëve mbi angazhimet tona, ne zotohemi se edhe në të ardhmen do të vazhdojmë t'iu ofrojmë informacionin me kohë dhe për kureshtjen tuaj, siç vazhdon të jetë edhe kjo praktikë e raportimit e shprehur përmes këtij Raporti.

4. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Në këtë përmbledhje janë pasqyruar informata të dala nga analizat e kryera mbi performancën e organizatës në të gjitha drejtimet, bazuar në mandatet e përcaktuara me Ligjin për IPK-në.

Jemi angazhuar që të rrisim besimin e qytetarëve në sistemin e trajtimit të ankesave:

- Kemi administruar **1.439** ankesa, të pranuar në mënyra të ndryshme;
- **35%** të tyre i orientuam për hetim penal në Departamentin e Hetimit;
- Pjesën e mbetur prej **65%** i kemi orientuar për hetim disiplinor në Divizionin e Standardeve Profesionale.

Ne u angazhuam në parandalimin dhe luftimin e krimit dhe keq-menaxhimit policor:

- Kemi hetuar **377** punonjës policor;
- Kemi ngritur **80** kallëzime penale ndaj të dyshuarve për vepra kriminale;
- Kemi arrestuar **41** punonjës dhe qytetarë nën dyshimin për përfshirje në krim;
- Kemi rekomanduar transferimin e tetë (**8**) punonjësve policorë;
- Kemi rekomanduar suspendimin e **70** punonjësve policorë.

Përmes aktiviteteve tona ndihmuam në përmirësimin e policimit:

- Realizuam shtatë (**7**) inspektime të planifikuara dhe të jashtëzakonshme, me analiza të thella dhe përmbajtjesore lidhur me të gjitha fushat e menaxhimit;
- Kontrolluam **925** dosje administrative (penale, financiare, prokurimit, etj.) dhe realizuam mbi **75** intervista;
- Rekomanduam avancimin e punës, efikasitetit dhe performancës përmes dhënies së **68** rekomandimeve;
- Verifikuam përbushjen e rekomandimeve nga fushat e ndryshme të inspektuara më parë.

Ne u angazhuam në sensibilizimin e qytetarëve për të shprehur përkushtimin tonë për trajtimin e shqetësimeve të tyre:

- Publikuam mbi **50** komunikata,
- Ofruam informacione për medie në mbi **300** kërkesa të tyre;
- Realizuam mbi **15** takime me qytetarë, forume të sigurisë, OJQ, institucione, etj.;
- Hartuam dokumente planifikuese dhe akte nënligjore;
- Finalizuam një marrëveshje ndërkombëtare për bashkëpunim dhe morëm pjesë në shumë forume dhe konferenca ndërkombëtare.



5. MENAXHIMI I ANKESAVE

Departamenti i Menaxhimit të Ankesave është ndarje organizative në kuadër të strukturës së organizimit të IPK-së që ka për objekt të veprimtarisë: pranimin e të gjitha ankesave të qytetarëve, si dhe shqyrtimin dhe përcaktimin, se cilat nga to hetohen nga IPK dhe cilat do t'i referohen Policisë apo institucioneve përgjegjëse¹.

Qytetarët e vendit dhe ata të huaj mund të paraqesin ankesë në DMA lidhur me pretendimet e tyre se ndonjë nga pjesëtarët e Policisë ka kryer detyrat në kundërshtim me rregullat e sjelljes.

Ankesë konsiderohet çdo parashtrësë e drejtuar në IPK nga ndonjë individ ose grup i interesit, me të cilën shprehen shqetësimet lidhur me sjelljen devijante të punonjësve policorë apo kur parashtrësja ka të bëjë me standardet policore apo udhëzimet operative.

Detyrat dhe përgjegjësitë e DMA-së janë: të sigurojë realizimin e politikave e procedurave të organizatës në menaxhimin e ankesave dhe të informacionit të disponueshëm mbi dyshimet për përfshirje të punonjësve të Policisë në vepra të kundërligjshme; të sigurojë mbajtjen e evidencave/regjistrave për ankesat dhe mbi bazën e tyre nxjerrë statistika me të dhëna për raportime; të sigurojë që informatat e disponueshme nga IPK-ja mbahen/ruhen sipas ligjeve përkatëse; të sigurojë që ankesat trajtohen duke u bazuar në parimet e përcaktuara me Ligjin e IPK-së².

Bazuar në Rregulloren mbi organizimin e brendshëm, DMA-ja përbëhet nga dy divizione:

- Divizioni i Trajtimit të Ankesave;
- Divizioni i Administrimit të Lëndëve.

DMA ka të punësuar tetë (8) punonjës.

DEPARTAMENTI I MENAXHIMIT TË ANKESAVE

Jemi angazhuar që të rrisim besimin e qytetarëve në sistemin e trajtimit të ankesave:

- Kemi administruar **1.439** ankesa përmes mënyrave të ndryshme;
- **35%** të tyre i orientuam për hetim penal në Departamentin e Hetimit;
- Pjesën e mbetur prej **65%** i kemi orientuar për hetim disiplinor në Divizionin e Standardeve Profesionale të Policisë.

¹Neni 2 i Ligjit të IPK-së (Fushëveprimi).

²Neni 15 i Rregullores (MPB) nr. 01/2017 (Departamenti i Menaxhimit të Ankesave).

Gjatë vitit 2019, DMA-ja ka pranuar dhe administruar gjithsej 1.439 ankesa³. Nëse shohim historikun e të dhënave statistikore për numrin e ankesave për tre vitet e fundit, shohim se viti i fundit ka shënuar një ngritje të numrit të përgjithshëm të ankesave për 1.4% dhe shënon numrin më të madh të ankesave të pranuar që nga themelimi i organizatës. Ngritja e numrit të ankesave është rezultat i ngritjes së besimit të qytetarëve të IPK, punës që bëjnë punonjësit në përmbushje të mandateve, promovimit të vlerave të IPK-së dhe sensibilizimit të qytetarëve për punën që bëjmë.



Sipas akteve ligjore dhe nënligjore të IPK-së, qytetarët kanë mundësi të ndryshme që të procedojnë ankesat e tyre. Nëse i referohemi statistikave të viteve të fundit, del se qytetarët më së shumti preferojnë të dorëzojnë fizikisht ankesat e tyre. Dorëzimi i ankesave në formë elektronike përmes internetit dhe në formë fizike përmes Policisë, janë disa nga mënyrat e shpeshta që preferojnë qytetarët.

Rreth 34% e ankesave të qytetarëve janë pranuar fizikisht në IPK, 24% e tyre kanë ardhur përmes postës elektronike dhe 22% kanë ardhur përmes Policisë. Mënyrat tjera të ushtrimit të ankesave janë preferuar më pak nga qytetarët dhe arrijnë në kuotën prej 18%. Kutitë e ankesave është një nga mënyrat më pak të preferuara nga qytetarët për të adresuar ankesat dhe përmes tyre gjatë vitit 2019 janë pranuar vetëm tre (3) ankesa apo 0.21% e numrit të përgjithshëm. Tabela nr. 1 pasqyron të dhëna mbi numrin e përgjithshëm të ankesave dhe mënyrat e ushtrimit të tyre.

Tabela nr. 1 - Të dhëna përmbledhëse mbi numrin e ankesave dhe mënyrat e paraqitjes së tyre			
Nr.	Mënyrat e paraqitjes së ankesave në IPK	Numri	Përqindja
1	Ankesa të pranuar në formë elektronike	347	24.11
2	Ankesa të pranuar fizikisht në IPK	495	34.40
3	Ankesa të pranuar në zyrat rajonale të IPK-së	52	3.61
4	Përmes kutive të ankesave	3	0.21
5	Ankesa anonime	15	1.04
6	Informata të pranuar në IPK	35	2.43
7	Ankesa (inicime) nga Departamenti Hetimeve	75	5.21
8	Ankesat e pranuar përmes postës	75	5.21
9	Ankesa të pranuar përmes institucioneve tjera ⁴	24	1.67
10	Ankesa të pranuar përmes Policisë së Kosovës	174	12.09
11	Inicime të brendshme nga Policia e Kosovës	144	10.01
	Gjithsej	1.439	100%

³Nga numri i përgjithshëm prej 1.439 ankesave, 35 prej tyre janë informata.

⁴Këtu hyjnë ankesat (rastet) e pranuar nga Prokurori i Shtetit, Avokati i Popullit, OJQ-të, etj.

Sipas të dhënave nga tabela më lartë, del se 1.097 ankesa (raste) apo 76.23% janë pranuar drejtpërdrejtë nga IPK-ja (renditja sipas numrave rendor 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7 e 8), derisa përmes institucioneve publike dhe OJQ - ve janë pranuar 342 ankesa (raste) apo 23.77% e numrit të përgjithshëm (renditja sipas numrave rendor 9, 10 dhe 11). Vërehet se rreth $\frac{3}{4}$ e numrit të përgjithshëm të ankesave pranohen drejtpërdrejtë nga IPK-ja, derisa $\frac{1}{4}$ e numrit të ankesave pranohen përmes institucioneve tjera dhe OJQ-ve.

Sipas të dhënave të DMA-së, në vitin 2019, 1.090 ankesa janë adresuar në IPK nga persona të gjinisë mashkullore, derisa 155 sosh nga persona të gjinisë femërore. Për pjesën e mbetur prej 194 ankesave, nuk ka qenë e mundur të dihet gjinia, për shkak të mënyrës që është përzgjedhur nga palët të ushtrohet ankesa dhe këtu hyjnë rastet e cilësuar si anonime apo iniciimet e brendshme, si dhe ankesat e ardhura nga institucionet tjera. Nuk vërehet ndonjë ndryshim në raportin mes gjinive lidhur me ushtrimin e ankesave, ngase në tre vitet e fundit kuota e pjesëmarrjes së femrave në numrin e përgjithshëm të ankesave arrin në rreth 11% (shih tabelën nr. 2).

Nr.	Ankuesit sipas gjinisë	2017	%	2018	%	2019	%
1	Meshkuj	902	73.6	1.032	72.7	1.090	75.7
2	Femra	136	11.1	161	11.4	155	10.8
3	E panjohur ⁵	188	15.3	226	15.9	194	13.5
	Gjithsej	1.226	100	1.419	100	1.439	100

Sipas të dhënave të DMA-së, në vitin 2019, 1.149 ankesa janë adresuar nga personat të përkatësisë shqiptare, 91 ankesa nga persona të pakicave dhe pesë (5) ankesa nga shtetas të huaj. Për 194 ankesa të pranuar në IPK, nuk dihet përkatësia e ankuesve dhe lidhet me iniciimet e brendshme, ankesat anonime, si dhe ankesat që kanë ardhur nga institucionet tjera. Vërehet se në tre (3) vitet e fundit, përqindja e personave të komuniteteve pakicë që kanë ushtruar ankesë në IPK është e njëjtë dhe arrin kuotën prej 6.3% dhe paraqet kuotën më të lartë në tre (3) vitet e fundit (përqindja ka lëvizur nga 6.2%, në vitin 2018 ka rënë në 5.5%, kurse në vitin 2019 është ngritur në 6.3%). Bazuar në këto të dhëna zyrtare, IPK gëzon besueshmëri në të gjitha komunitetet që jetojnë në Kosovë. Besohet se kësaj i ka kontribuar edhe organizimi i fushatave të vetëdijesimit qytetar në disa lokalitete ku jetojnë pjesëtarë të pakicave, të cilët kanë pasur mundësi të njihen me punën që bën agjencia dhe mundësitë që ofron bashkëpunimi në trajtimin e shqetësimeve të tyre.

Nr.	Ankuesit sipas gjinisë	2017	%	2018	%	2019	%
1	Shqiptar	956	78.0	1.111	78.3	1.149	79.8
2	Serb	62	5.1	65	4.6	74	5.1
3	Turq	8	0.7	3	0.2	2	0.1
4	Boshnjak	1	0.1	9	0.6	13	1.0
5	RAE	4	0.3	1	0.1	2	0.1
6	Të huaj	7	0.6	4	0.3	5	0.4
7	E panjohur	188	15.3	226	15.9	194	13.5
	Gjithsej	1.226	100	1.419	100	1.439	100

⁵Këtu hyjnë iniciimet zyrtare, iniciimet e brendshme, anonime, etj.

Muaji më i ngarkuar me numër të ankesave përgjatë vitit 2019 ka qenë muaji tetor, në të cilin janë regjistruar 153 ankesa apo 10.6% e numrit të përgjithshëm të ankesave të pranuar gjatë vitit. Tetori ka ndryshuar praktikën e deritanishme duke marrë epitetin e muajit më të ngarkuar me raste, pasi që në vitet e kaluara, gushti ka qenë muaji më i ngarkuar me numër më të madh të ankesave. Muaji janar vazhdon të mbetet muaji me më së paku ankesa të pranuar gjatë tre (3) viteve të fundit. Në vitin 2019, numri i ankesave të pranuar gjatë janarit ka qenë 87 sosh apo 6.05% e numrit të përgjithshëm të ankesave (shih tabelën nr. 4).


Nr.	Muaji	2017	%	2018	%	2019	%
1	Janar	64	5.22	97	6.84	87	6.05
2	Shkurt	102	8.32	117	8.25	103	7.16
3	Mars	108	8.81	112	7.89	113	7.85
4	Prill	93	7.59	113	7.96	121	8.41
5	Maj	104	8.48	130	9.16	101	7.02
6	Qershor	99	8.08	99	6.98	112	7.78
7	Korrik	108	8.81	116	8.17	134	9.31
8	Gusht	142	11.58	158	11.13	139	9.66
9	Shtator	134	10.93	124	8.74	120	8.34
10	Tetor	98	7.99	112	7.89	153	10.63
11	Nëntor	98	7.99	141	9.94	138	9.59
12	Dhjetor	76	6.20	100	7.08	118	8.20
	Gjithsej	1.226	100	1.419	100	1.439	100

Të dhënat e administruara nga IPK mundësojnë të kuptojmë edhe drejtoritë policore më të atakuara me numër të ankesave të qytetarëve. Sipas të dhënave, ankesat më të shumta janë adresuar për punonjësit e DRP - Prishtinë dhe arrijnë në 43% të numrit të përgjithshëm të ankesave. Ndërsa, më pak të atakuar mbesin DRPK - Lindja dhe Veriu (shih tabelën 5).

Nr.	Drejtoritë	Numri	Përqindja
1	DRP – Prishtinë	623	43
2	DRP – Pejë	137	10
3	DRP – Ferizaj	119	8
4	DRP – Prizren	117	8
5	DRP – Gjiilan	105	7
6	DRP - Mitrovicë Jugu	88	6
7	DRP - Mitrovicë Veriu	55	4
8	DRP – Gjakovë	90	6
9	DRPK – Veriu	6	0
10	DRPK – Lindja	4	0
11	DRPK – Perëndimi	11	1
12	I pa lokalizuar	84	6
	Gjithsej	1.439	100

IPK-ja pas shqyrtimit dhe analizimit të ankesave, ato që përmbajnë elemente të përfshirjes së punonjësve policor në vepra penale, procedohen në Departamentin e Hetimeve të IPK-së për trajtim të mëtejshëm. Gjatë vitit 2019, 504 ankesa apo 35.02% të numrit të përgjithshëm të tyre të pranuar në IPK, janë proceduar në Departamentin e Hetimeve të IPK-së. Kur IPK kualifikon se ankesat përmbajnë elemente të përfshirjes së punonjësve policorë në shkelje disiplinore, ato i procedon në DSP në kuadër të Policisë. Gjatë vitit 2019, numri i këtyre ankesave ka arritur në 934 sosh (64.91% e numrit të përgjithshëm të ankesave të pranuar). Është evidentuar një (1) rast, ku ankesa është proceduar në institucion tjetër përgjegjës.

Rreth 1/3 e numrit të përgjithshëm të ankesave të pranuar, janë kualifikuar me elemente të veprave penale, derisa pjesa tjetër prej 2/3 janë kualifikuar me elemente të shkeljeve disiplinore. Nuk janë evidentuar raste që ankesat të jenë proceduar në DH për t'u trajtuar për shkelje disiplinore, apo në Departamentin e Inspektimeve për ndonjë inspektim eventual.





6. HETIMET PENALE

Departamenti i Hetimeve është një ndarje organizative në kuadër të strukturës së organizimit të IPK-së dhe funksionon që nga viti 2007. Objekt i veprimtarisë së Departamentit të Hetimeve është: parandalimi, zbulimi, dokumentimi dhe hetimi i veprave penale të kryera nga punonjësit e Policisë së Kosovës, pa dallim grade dhe pozite gjatë ushtrimit të detyrës ose jashtë saj; hetimi i incidenteve disiplinore të profilit të lartë, ku përfshihen të gjithë punonjësit e Policisë; hetimi i të gjitha shkeljeve disiplinore të supozuara të zyrtarëve policor me gradën më të lartë të nivelit të lartë të menaxhimit dhe zyrtarëve policorë të nivelit të lartë ekzekutiv; kur ekziston dyshimi i bazuar se Drejtori i Përgjithshëm i Policisë ka kryer shkelje disiplinore, Kryeministri mund të autorizojë IPK-në për zhvillim të hetimeve disiplinore. IPK-ja pas përfundimit të hetimeve disiplinore i raporton Kryeministrit për të gjeturat⁶.

Përgjegjësitë (detyrat) e Departamentit janë: kryen hetime penale si dhe disiplinore ndaj punonjësve të Policisë; zbaton masat e fshehta hetimore në funksion të fushëveprimit, të autorizuara nga autoriteti kompetent; zbaton metoda apo teknika të ligjshme për të zhvilluar kapacitetin proaktiv në ruajtjen e etikës dhe integritetit, në kuadër të standardeve të larta profesionale policore; bashkëpunon me Prokurorinë në fushën e hetimeve dhe shfrytëzon burime të ligjshme të informacionit për nevoja operative; nxjerrë raporte mbi rrjedhën e hetimeve të zhvilluara dhe kallëzime penale varësisht nga rezultati i hetimeve; ndërmerr veprime të nevojshme ligjore për të siguruar dhe vlerësuar informatat inteligjente; siguron mbështetje teknike në funksion të hetimeve (përdorë pajisje teknike në funksion të realizimit të masave të veçanta, siguron dhe trajton dëshmi nga vendngjarja)⁷.

Hetuesit e DH-së gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre, kanë autorizime policore dhe i ushtrojnë ato në përputhje me Kushtetutën, Kodin Penal, Kodin e Procedurës Penale, me këtë ligj, si dhe me ligjet dhe aktet nënligjore tjera në fuqi.

Hetuesit zhvillojnë aktivitetin e tyre në tetë (8) divizione. Departamenti ka të punësuar 44 hetues.

⁶Neni 2 i Ligjit të IPK-së (Fushëveprimi).


⁷Neni 6 i Rregullores (MPB) nr. 01/2017 (Departamenti i Hetimeve).

DEPARTAMENTI I HETIMEVE

Ne u angazhuam në parandalimin dhe luftimin e krimit dhe keqmenaxhimit policor:

- Kemi hetuar **377** punonjës policor;
- Kemi ngritur **80** kallëzime penale ndaj të dyshuarve për vepra kriminale;
- Kemi arrestuar **41** punonjës dhe qytetarë nën dyshimin për përfshirje në krim;
- Kemi rekomanduar transferimin e tetë (**8**) punonjësve policorë;
- Kemi rekomanduar suspendimin e **70** punonjësve policorë.


Raporti përmblendhës për hetime penale përmban aktivitete të realizuara në suaza të përgjegjësive që rrjedhin nga dispozitat e përcaktuara në Ligjin për IPK, në veçanti për Departamentin e Hetimit, si dhe të dhënat që janë regjistruar në Librin fizik dhe elektronik të evidencës. Bazuar në të dhënat nga evidencat zyrtare, gjatë vitit 2019, subjekt i hetimit nga IPK kanë qenë gjithsej 377 punonjës policor. Shprehur në përqindje, 4.2% e numrit të përgjithshëm të punonjësve policorë janë hetuar me dyshimin se kanë kryer vepra penale⁸. Nëse këtë përqindje e krahasojmë me të vitit të kaluar, del se në vitin 2019, numri i të hetuarve në radhët e Policisë është për 1.9% më i lartë se në vitin 2018 (në vitin 2019, numri i punonjësve të hetuar është më i madh për 179 punonjës).



Viti 2019 konsiderohet një vit i suksesshëm për DH-në bazuar në të dhënat lidhur me numrin e rasteve të trajtuara, numrin e kallëzimeve penale, numrin e të arrestuarve, etj. Përgjatë vitit 2019, DH-ja ka pranuar 504 raste përmes DMA-së, kurse në mënyrë të drejtpërdrejtë ka regjistruar me numër penal edhe 141 raste tjera që me kërkesë të Prokurorit kompetent janë regjistruar drejtpërdrejt në Librin fizik të hetimeve (sipas Librit të dhënave zyrtare, DH-ja ka pranuar gjithsej 645 raste). Nga vitet paraprake janë bartur në vitin 2019, 174 raste që në fund të vitit 2018 janë konsideruar si raste nën hetim preliminar.

Prej numrit të përgjithshëm të rasteve të pranuar në DH gjatë vitit 2019 (gjithsej 645 raste), pas veprimeve të ndërmarra hetimore gjendja rezulton si në vijim:


- 220 raste (34%) janë dërguar në DSP për hetim të mëtejshëm disiplinor;
- 244 raste (38%) janë regjistruar si raste penale;
- 181 raste (28%) janë në proces të hetimit preliminar dhe barten në vitin 2020.



⁸Shifra prej 8.898 punonjësve policorë është siguruar nga Divizioni për Personel dhe Administratë në kuadër të Departamentit të Burimeve Njerëzore në Policinë e Kosovës (12 dhjetor 2019).

Gjatë vitit 2019, DH-ja me numër penal ka regjistruar 279 raste⁹ (35 prej të cilave janë raste nga kategoria e rasteve në hetim preliminar të bartura nga viti 2018 në vitin 2019), 256 sosh pas hetimeve të zhvilluar i ka dërguar në Prokuroritë kompetente, ndërsa 23 të tjera të mbetura i ka bartur për hetim në vitin 2020.

Duhet cekur veç tjerash, se 174 rastet e bartura nga viti 2018 që janë konsideruar si raste në hetim preliminar, janë trajtuar në vitin 2019 dhe nga to: 97 sosh janë dërguar në Polici gjatë vitit 2019, 33 janë regjistruar si raste penale, 36 janë përcjellë si informata për trajtim në Divizionin e Inteligjencës dhe Analizës, si dhe tetë (8) raste i u janë bashkëngjitur rasteve tjera. Numri i rasteve që kanë marrë numër penal në vitin 2019 krahasuar me një vit më parë ka shtuar ngarkesën e Departamentit me raste penale për 95% raste më shumë për hetim. Kjo rritje ka ardhur edhe si rezultat i hetimeve për invalidët e luftës brenda Policisë. Ky rast përshkak të numrit të madh të të dyshuarve është ndarë në raste të veçanta, me kërkesë të Prokurorit kompetent.



Se si janë përcjellë gjatë vitit 2019, 256 rastet penale te Prokuroritë kompetente, në mënyrë të detajuar janë paraqitur më poshtë të dhënat mbi rastet. Nga diagrami nr. 6 shihet se numri i kallëzimeve penale ka shënuar një rënie për 11%, derisa numri i rasteve të dërguara në Prokurori me raport të veçantë ka shënuar ngritje për 94% krahasuar me një vit më parë. Përveç lëndëve penale të regjistruara në vitin 2019, DH-ja ka proceduar në Prokuroritë kompetente edhe dhjetë (10) kallëzime tjera penale, pesë (5) raporte të veçanta dhe tetë (8) raporte informuese nga lëndët penale të bartura nga viti 2018. Më poshtë shihen rezultatet e trajtimit të rasteve në kompetencë të DH-së gjatë vitit 2019:


- a) 80 raste (31%) janë dërguar në Prokurori me kallëzime penale¹⁰;
- b) 35 raste (14%) janë dërguar në Prokurori me raporte të veçanta¹¹;
- c) 141 raste (55%) janë dërguar në Prokurori me raport informues¹².

⁹35 nga gjithsej 279 raste penale të regjistruar me numër penal në vitin 2019 janë raste nga kategoria e rasteve në hetim preliminar të bartura nga viti 2018 në vitin 2019.

¹⁰Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, neni 81, paragrafi 1.


¹¹Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, neni 81, paragrafi 4.

¹²Këto janë raste, të cilat me kërkesë të prokurorisë kompetente, DH-ja i ka regjistruar drejtpërdrejtë në Librin fizik të hetimeve dhe për të cilat Prokuroria do të ndërmarrë veprime të mëtejme hetimore.



Për kallëzimet penale të ngritura dhe lëndët e dërguar në Prokurori, IPK pranon vazhdimisht informata mbi statusin e tyre. Aktakuzat që IPK i ka pranuar gjatë vitit 2019 nuk pasqyrojnë vetëm statusin e lëndëve të hetuara nga IPK-ja gjatë vitit 2019 dhe për këtë arsye njoftimet për ngritjen e aktakuzave apo hedhjen e tyre nuk pasqyrohen në këtë raport.


Si rezultat i proceseve hetimore dhe angazhimeve të personelit hetimor, gjithmonë kur janë plotësuar kushtet ligjore, DH-ja ka kryer arrestime të të dyshuarve për përfshirje në vepra penale, duke vënë në zbatim dispozitat e përcaktuara me Kodin e Procedurës Penale të Kosovës¹³. DH-ja rekomandon edhe masa administrative për suspendimin dhe transferimin e zyrtarëve policorë, duke vënë në zbatim dispozitat e parapara në Ligjin për IPK-në¹⁴. IPK-ja gjatë vitit 2019 ka realizuar gjithsej 41 arrestime, ka rekomanduar 70 suspendime dhe tetë (8) transfere. Numri i të arrestuarve është ngritur për 242% krahasuar me një vit më parë falë angazhimeve të hetuesve në bashkëpunim me Prokurorinë e Shtetit në disa operacione të ndara në luftimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit. Numri i rekomandimeve për suspendim ka shënuar ngritje për 43% krahasuar me vitin paraprak. Numri i rekomandimeve për transfere të punonjësve policor është i baraspeshuar në tre vitet e fundit.




¹³Kur një person kapet në flagrancë gjatë kryerjes së veprës penale, e cila ndiqet sipas detyrës zyrtare ose është në ndjekje për veprën e kryer penale, policia ose çdo person tjetër është i autorizuar ta arrestojë atë përkohësisht edhe pa urdhër të gjykatës. Personi të cilit i është hequr liria nga persona të tjerë përpos policisë, menjëherë i dorëzohet policisë, e kur kjo është e pamundur menjëherë njoftohet Policia ose Prokurori i Shtetit. Policia vepron në pajtim me nenin 163 dhe 164 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës.

¹⁴Kur IPK-ja konsideron se është në interes të hetimit, i rekomandon Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë, formën e veprimit që mund përfshijë, por nuk kufizohet në llojet e suspendimit me pagesë apo transferimin. Rekomandimi duhet të shoqërohet me një deklaratë, e cila përmban arsyet e rekomandimit (Ligji nr. 03/L-231, neni 17, pika 12).

Gjatë vitit 2019, DH ka hetuar raste të llojeve dhe natyrave të ndryshme. Pesë (5) veprat penale më të shpeshta që u hetuan gjatë vitit 2019 janë të pasqyruara si në diagramin nr. 8:



Gjatë viteve të kaluara (2017-2019) pothuajse të njëjtat vepra kanë prirë në listën e pesë veprave më të shpeshta në kompetencë të DH-së për hetim. Ka trend të rënies së numrit të veprave penale të “Rrezikimit të trafikut publik” dhe “Keqtrajtimit gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare”. Bazuar në të dhënat e IPK-së, vepra penale “Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar” ka trend rënës. Shqetësuese mbetet ngritja e numrit të veprave penale “Mashtrim”, si rezultat i rastit të invalidëve të luftës, për të cilin Prokuroria kompetente ka kërkuar që rasti të regjistrohet për secilin të dyshuar me numër të veçantë.



Gjatë vitit 2019, DH është përkushtuar që me gjithë potencialin të vë theks në luftën kundër korrupsionit. Janë hetuar 36 raste me vepra penale “Korrupsioni zyrtar” dhe “Veprat penale kundër detyrës zyrtare”, ndër të cilat më të shpeshtat kanë qenë: 26 vepra “Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar”, katër (4) vepra “Marrje e ryshfetit”, një (1) vepër “Falsifikimi i dokumentit zyrtar”, një (1) vepër “Ushtrim i ndikimit”, një (1) vepër “Zbulim i fshehtësisë zyrtare”, një (1) vepër “Përvetësim në detyrë” dhe një (1) vepër “Konflikti i interesit”. Sa i përket veprës penale “Dhënie e ryshfetit” nuk është shfaqur asnjë rast gjatë kësaj periudhe. Nga 36 raste nga kapitulli i veprave penale “Korrupsioni zyrtar” dhe “Vepra penale kundër detyrës zyrtare”, IPK-ja ka arrestuar 33 punonjës policor, ka rekomanduar suspendim për 35 nga ta. Si rezultat i hetimit të kësaj natyre të veprave penale, IPK ka arrestuar edhe katër (4)

qytetarë. Lidhur me këto raste, DH-ja ka dërguar në Prokurori, 12 kallëzime penale, nëntë (9) raporte të veçanta dhe nëntë (9) raste janë të hapura për hetim të mëtejshëm.

Nr.	Lloji i veprës penale	2017	2018	2019
1	Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar	32	27	26
2	Falsifikim i dokumentit zyrtar	2	4	1
3	Marrje e ryshfetit	6	1	4
4	Ushtrim i ndikimit	3	1	1
5	Zbulim i fshehtësisë zyrtare	2	3	1
5	Dhënie e ryshfetit	0	0	0
6	Përvetësim në detyrë	0	0	1
7	Konflikt i interesit	0	0	1
8	Keqpërdorim i informatës zyrtare	0	0	1
	Gjithsej	45	36	36

Policia e Kosovës ka gjithsej 8.898 punonjës, nga të cilët 7.882 janë zyrtarë policorë dhe zyrtarë me grada të ndryshme, ndërsa personel civil - pa kompetenca policore janë 1.016. Në diagramin në vazhdim pasqyrohen të dhënat lidhur me 377 punonjësit policor të hetuar nga IPK-ja. Në diagram është bërë shpërndarja sipas gradave e punonjësve policor të hetuar. IPK ka bërë matje për të vërtetuar se cila nga gradat policore është më e prekura nga hetimet dhe ka rezultuar se grada nënkolonel është më e prekura dhe kjo vërehet kur vejmë në raport numrin e të hetuarve brenda gradës me 100 punonjës me gradë përkatëse. Shihet se brenda secilës kategori të punësuarish, grada nënkolonel është më e prekura dhe përfaqësohet me numër më të lartë të të hetuarve brenda kategorisë. Tek kjo kategori pasqyrohet se në 100 nënkolonelë, subjekt hetimi ka qenë çdo i njëmbëdhjeti prej tyre. Më pas renditet grada kapiten, ku në 100 kapitenë, subjekt i hetimeve nga qenë çdo i shtati prej tyre dhe grada kolonel, ku në 100 kolonelë, subjekt i hetimeve ka qenë çdo i gjashti prej tyre. Kategoria e policëve të rinjë dhe ajo e shërbyesve civilë është më së paku e atakuar

Numri	Kolonel	N/kolonel	Major	Kapiten	Toger	Rreshter	Polic	Polic i ri	Shërbyes civil
Numri i punonjësve	33	55	92	170	240	1122	5754	416	1016
Numri i të hetuarve nga IPK	2	6	5	12	13	57	268	1	13
Raporti (1:100)	6:100	11:100	5:100	7:100	5:100	5:100	5:100	0:100	1:100


Diagrami radhës pasqyron krahasimet e numrit të punonjësve policor të hetuar nga IPK-ja në tre (3) vitet e fundit sipas gradave. Nga evidencat zyrtare që posedon IPK-ja, subjekt i hetimeve kanë qenë edhe zyrtarë policorë të graduar dhe nëse shifrat i krahasojmë me një vit më parë, del se në vitin 2019 si subjekt i hetimeve të DH-së është shtuar numri i të hetuarve në të gjitha gradat policore. Përfundimisht bën numri i të hetuarve nga radhët e shërbyesve civil. Numri i të hetuarve nga radhët e kolonellëve është ngritur nga 0 në 2, të nënkolonellëve nga 1 në 6, të majorëve nga 1 në 5, të kapitenëve nga 4 në 12, të togerëve nga 2 në 13 dhe të rreshterëve nga 12 në 57.

Tabela nr. 8 - Pasqyra e të hetuarve nga Departamenti i Hetimeve të IPK-së (2017-2019)

Numri i të hetuarve nga IPK-ja sipas gradave	Kolonel	N/kolonel	Major	Kapiten	Toger	Rreshter	Polic	Polic i ri	Shërbyes civil
Viti 2017	0	1	0	3	10	19	148	0	9
Viti 2018	0	1	1	4	2	12	150	0	24
Viti 2019	2	6	5	12	13	57	268	1	13


Policia në bazë të strukturës organizative aktuale përbëhet nga pesë (5) departamente, ku numrin më të madh të personelit prej 6.460 punonjësve e ka Departamenti për Operacione, pasi që i njëjti përfshin tetë (8) drejtori rajonale policore dhe 41 stacione policore. Bazuar në këtë shpërndarje të personelit policor edhe numri më i madh i zyrtarëve të hetuar nga IPK-ja është pikërisht nga ky Departament. Diagrami në vazhdim pasqyron numrin e punonjësve policor të hetuar nga IPK, të ndarë në departamente. DH ka hetuar një (1) punonjës policor deri sa ka qenë kadet. Në gjithë departamentet ka ngritje të numrit të punonjësve që kanë qenë subjekt hetimi në IPK, në përjashtim të Departamentit për Shërbime Mbështetëse ku ka një rënie të numrit të të hetuarve gjatë viti 2019 krahasuar me një vit më parë.

Diagrami nr. 10 - Shpërndarja e të hetuarve sipas departamenteve (2017-2019)




Bazuar në atë se Departamenti për Operacione përbëhet nga tre (3) divizione, të dhënat e paraqitura në diagram japin pasqyrën e shpërndarjes së 256 punonjësve policor të hetuar në Departamentin për Operacione. Pjesa dërmuese e të hetuarve është shpërndarë në Divizionin për Siguri Publike, ku janë strukturuar drejtoritë rajonale dhe stacionet. Kemi një ngritje të numrit të të hetuarve për 84% krahasuar me një vit më parë. Edhe në radhët e Divizionit të Njësive të Specializuara ka ngritje të numrit të të hetuarve nga 11 në 32.


Diagrami nr. 11 - Shpërndarja e 256 punonjësve të hetuar nga IPK, punonjës nga Departamenti për Operacione sipas nëndarjeve të saj në divizione




Diagrami në vazhdim jep pasqyrën e shpërndarjes së të hetuarve në nivel drejtorish rajonale policore, të cilat në numrin e përgjithshëm janë tetë (8) dhe përfshijnë DRP-të në Prishtinë, Mitrovicë Veriu, Prizren, Ferizaj, Mitrovicë Jugu, Gjilan, Pejë dhe Gjakovë. Gjatë vitit 2019 janë hetuar 215 punonjës policor të angazhuar në këto drejtori. Diagrami pasqyron se DRP - Prishtinë prinë nga të gjitha drejtoritë me numrin më madh të të hetuarve nga radhët e saj duke patur edhe numrin më të madh të punonjësve të shpërndarë në stacione policore që janë më të shumta krahasuar me drejtoritë tjera, pason DRP - Pejë, DRP - Ferizaj e me radhë. Ngritje të theksuar të numrit të të hetuarve krahasuar me një vit më parë ka shënuar DRP - Pejë me 362.5%, DRP - Mitrovicë Jugu me 220%, DRP - Gjakovë me 188.9%, DRP - Prishtinë me 152.2%, etj. Rënie të numrit të të hetuarve ka shënuar DRP - Gjilan me 17.7% krahasuar me një vit më parë.




Përshkallëzimi tjetër strukturor në drejtoritë rajonale bie në nivelin e stacioneve policore, të cilat në numrin e përgjithshëm janë 41 stacione policore të shpërndara në tërë vendin. Sipas të dhënave zyrtare, Stacioni Policor në Drenas ka pasur numrin më të madh të punonjësve të hetuar nga DH-ja me gjithsej 14 punonjës, pasuar nga Stacioni Policor - Prishtinë Jugu me 12 punonjës, etj. Të dhënat lidhur me numrin e të hetuarve sipas ndarjes në nivel stacionesh policore janë të paraqitura në diagramin e radhës. Stacionet policore në Mamushë, Vushtrri, Partesh, Obiliq dhe Rranilluk nuk kanë pasur të përfshirë në hetime asnjë punonjës policor.



Po ashtu, edhe Policia e Kufitare në organizimin e saj strukturor është e përshkallëzuar edhe në nivelin e Drejtorive Rajonale të Policisë Kufitare, të cilat janë të ndarë në nivele dhe më konkretisht në DRPK - Veriu, DRPK - Lindje, DRPK - Perëndimi dhe Aeroporti i Prishtinës. Nga të dhënat e paraqitura në diagram shihet se DRPK - Veriu kryeson me numrin më të madh të hetuarve nga IPK-ja me gjithsej 36 punonjës policor, pasuar nga DRPK - Perëndimi me 18 punonjës të hetuar, etj. Nga të dhënat shihet se të gjitha drejtoritë rajonale kufitare kanë shënuar ngritje të numrit të të hetuarve nga IPK-ja. Ngritjen më të madhe e ka shënuar DRPK - Veriu me 620% dhe në këtë ngritje ka ndikuar hetimi që lidhet me arrestimin e një numri të dyshuarish nga radhët e kësaj drejtorie në kuadër të operacionit “Kontrabanda”.



Përshkallëzimi tjetër strukturor në DRPK bie në nivel të SPK-ve dhe SPMK-ve, që në numrin e përgjithshëm janë gjithsej 27 sosh, të shpërndara në tërë vendin përgjatë vijës kufitare. Nga të dhënat e paraqitura shihet se SPMK-Zubin Potok kryeson me 24 punonjës policorë të hetuar nga IPK-ja gjatë vitit 2019, pasuar nga Stacioni Policor - Aeroporti dhe SPK - Vërmicë me nga shtatë (7) punonjës policor të hetuar, etj. SPK - Jarinje, SPMK - Keqekollë, SPK - Izvor, SPK-Kullë, SPMK-Kërpimëh, SPMK-Zhegër, SPK-Muqibabë, SPMK-Gjilan, SPK-Kapi, SPMK- Dragash dhe SPK - Mutivodë nuk kanë të përfshirë punonjës në procese hetimore të IPK-së.



Bazuar në fushëveprimin ligjor të IPK-së, sa i përket incidenteve të profilit të lartë dhe shkeljeve disiplinore të nivelit të lartë të menaxhimit dhe atyre të nivelit të lartë ekzekutiv, gjatë vitit 2019, DH-ja ka regjistruar vetëm dy (2) raste me karakter disiplinor që lidhen me shkelje disiplinore të profilit të lartë.



7. INSPEKTIMET E STRUKTURAVE DHE FUNKSIONEVE POLICORE

Departamenti i Inspektimit është një ndarje organizative në kuadër të strukturës së organizimit të IPK-së dhe si i tillë funksionon që nga viti 2006. Objekt i veprimtarisë së Departamentit është inspektimi i strukturave dhe funksioneve të Policisë së Kosovës për të siguruar llogaridhënie, efektivitet e efikasitet në zbatimin e ligjeve, akteve nënligjore dhe procedurave standarde të operimit në fuqi¹⁵.

Departamenti në përmbushje të mandatit ushtron mbikëqyrje të vazhdueshme policore dhe këtë e realizon përmes inspektimit, që për nga natyra mund të jenë të rregullta dhe të jashtëzakonshme. Inspektimet janë vlerësime të mënyrës së kryerjes së detyrave nga Policia e Kosovës, duke siguruar arritjen e qëllimeve në përputhje me legjislacionin dhe standardet e kërkuara¹⁶.

Përgjegjësitë dhe detyrat e Departamentit janë: nxjerrja e Planit Vjetor të Inspektimit në fushat e menaxhimit policor të përcaktuar me Ligjin për IPK-në, kryerja e inspektimeve në Polici me iniciativë të vetën ose me urdhër të Ministrit, sigurimi i informatave nga fusha menaxheriale përmes metodave të autorizuara të marrjes dhe sigurimit të tyre, analizimi dhe vlerësimi i kryerjes së detyrave nga struktura policore, hartimi i raporteve të inspektimit të bazuara në standardet e raportimit, duke përfshirë në to gjetjet, përfundimet dhe rekomandimet¹⁷.

Departamenti është strukturuar në dy divizione:

- Divizionin për Analizë, Planifikim dhe Cilësi;
- Divizionin e Inspektimit dhe Raportimit.

Momentalisht në funksion të IPK-së, Departamenti i Inspektimit ka të angazhuar 14 inspektorë.

¹⁵Neni 2 i Ligjit të IPK-së (Fushëveprimi).

¹⁶Neni 4 i Ligjit të IPK-së (Përkufizimet).

¹⁷Neni 18 i Rregullores (MPB) nr. 01/2017 (Departamenti i Inspektimit).

DEPARTAMENTI I INSPEKTIMIT

Përmes aktiviteteve tona ndihmuam në përmirësimin e policimit:

- Realizuam shtatë (7) inspektime të planifikuara dhe të jashtëzakonshme, me analiza të thella dhe përmbajtësore lidhur me të gjitha fushat e menaxhimit;
- Kontrolluam 925 dosje administrative (penale, financiare, prokurimit, etj) dhe realizuam mbi 75 intervista;
- Rekomanduam avansimin e punës, efikasitetit dhe performancës përmes dhënies së 68 rekomandimeve;
- Verifikuam përmbushjen e rekomandimeve nga fushat e ndryshme të inspektuara më parë.

Siç parashihet në nenin 25, paragrafi 1 të Ligjit nr. 03/L-231 të IPK-së, brenda tremujorit të parë të vitit, Udhëheqësi i Departamentit të Inspektimit i ka dorëzuar Kryeshefit Ekzekutiv të IPK-së, Planin Vjetor të Inspektimeve të Rregullta (2019). Ky autoritet, më 11.02.2019 ka miratuar Planin Vjetor të Inspektimeve¹⁸. Plani ka marrë në konsideratë obligimet që dalin nga Plani Strategjik Zhvillimor, rëndësinë e programeve, rreziqet e identifikuara, rezultatet e inspektimeve të kaluara, kapacitetet njerëzore të Departamentit të Inspektimit dhe çështjet e patrajuara.

Viti 2019 ishte një vit tjetër produktiv për Departamentin e Inspektimit, duke realizuar shtatë (7) raporte të rëndësishme të dala nga pesë (5) inspektime të rregullta dhe dy (2) të jashtëzakonshme. Raportet e inspektimit kanë rezultuar me gjithsej 70 rekomandime.

Inspektorët kanë përdorë metoda e teknika të mbledhjes së të dhënave, përfshirë këtu intervistat, këqyrjet - kontrollet, verifikimet përmes përdorimit të formularëve, marrjet e dokumenteve, etj. Inspektorët kanë realizuar 75 takime e intervista me bartës funksionesh, kanë siguruar 925 dosje dhe një numër të madh raportesh, planesh e dokumentesh tjera me rëndësi për fushat. Në vazhdim pasqyrojmë një përmbledhje të shkurtuar mbi gjetjet.

Inspektimi nr. 01/2019:

Vlerësimi i performances policore në trajtimin e grabitjeve me armë

Më 31.12.2018, Kryeshefi Ekzekutiv ka kërkuar iniciimin e inspektimit të jashtëzakonshëm për të vlerësuar performancën policore në trajtimin e veprave penale që lidhen me grabitjet e bizneseve dhe familjeve nga grupet kriminale. Ky iniciim ka pasuar pas shqetësimeve të Ministrisë të Punëve të Brendshme për trendin në ngritje të rasteve të grabitjeve dhe nevojën për të vlerësuar kapacitetet dhe angazhimet në trajtimin e kësaj dukurie, drejt dhënies së opinionit mbi efikasitetin në hetimin dhe zbulimin e krimit. Inspektimi është përqendruar në drejtoritë rajonale, përfshirë edhe stacionet e prekura nga ky aktivitet kriminal. Gjatë punës në terren janë zhvilluar intervista - takime me së paku 11 punonjës e bartës të funksioneve, janë plotësuar formularët e inspektimit për verifikim dhe janë siguruar e kontrolluar rreth 20 dosje hetimore që lidhen me rastet e grabitjeve me armë.

Viteve të fundit në opinion ishte dëgjuar me të madhe për grabitjet, të cilat kanë shqetësuar qytetarët dhe bizneset. Shqetësimet janë rritur edhe pas raportimeve se ato në shumë situata janë manifestuar me përdorim të forcës. Ishin raportuar humbje financiare, por edhe jetëra të rrezikuara. Rreth 2/3 e numrit të përgjithshëm të tyre ishin raportuar në kuadër të zonës së përgjegjësisë që kontrollon DRP- Prishtinë, duke e bërë më të prekurën nga grabitjet, derisa DRP - Gjakovë kishte qenë më pak e ngarkuar me raste. Rreth 2/3 e numrit të përgjithshëm të rasteve të grabitjeve, të cilat janë raportuar gjatë vitit 2018 kishin qenë grabitje me armë.



Grabitjet me armë më shumë kishin atakuar filialet bankare-këmbimore, kazinotë- bastoret sportive, pompat e derivateve, marketet, shtëpitë, kalimtarët, etj. Zona e përgjegjësisë së

¹⁸Departamenti i Inspektimit, *Plani Vjetor i Inspektimeve të Rregullta (2019)*, nr. 04-052-192, datë 11.02.2019.

DRP - Prishtinë kishte qenë më e atakuar nga grabitjet, si zonë me sipërfaqe më të gjerë dhe koncentrim më të madh të njerëzve dhe bizneseve. Rreth 2/5 e numrit të përgjithshëm të grabitjeve me armë kishte prekur zonat rurale, krahasuar me 3/5 që kishte prekur ato urbane. Muajt më të ngarkuar me raste të grabitjeve me armë në vitin 2018 në nivel vendi kishin qenë gushti dhe shtatori. Në një numër të konsideruar të grabitjeve me armë, kishte pasur rezistencë ndaj urdhrave policore, për të pamundësuar kapjen në flagrancë të kryesve të tyre. Grabitjet ishin manifestuar me përdorim të armëve të gjata - të shkurtra, armëve të ftohta dhe pajisjeve tjera në funksion të kryerjes së veprës penale nga kryes individual dhe në grupe të organizuar deri në dhjetë (10) persona.

DPP nga viti 2009 ka në fuqi Urdhrin Operativ "Unaza e çeliktë", që aktivizohet në të gjitha rrethanat kur nuk arrihet që kryesit të kapen në flagrancë ose pas kryerjes së një numri të veprave penale, përfshirë edhe ato të grabitjeve me armë. Për shkak të ngritjes së një numri veprash penale, kjo Drejtori në vitin 2017 ka nxjerrë Urdhrin Operativ "Rrjeta-2017". Numri i informatave inteligjente mbi grabitjet konsiderohet jo i kënaqshëm për disa drejtori rajonale dhe konsiderohet si rezultat i një përafrimi jo të duhur me komunitetin, aty ku vlerësohet se mund të merret informacioni. DIA ka bërë një punë të kënaqshme në mbledhjen, analizimin dhe shpërndarjen e informacionit inteligjent mbi grabitjet. Duke qenë të shqetësuar për numrin e grabitjeve që për fokus vazhduan të kenë bizneset, duke mos kursyer as qytetarët, DPP pas vlerësimit të rrezikut dhe kërcënimit nga grabitjet, në pjesën e dytë të vitit 2018 ka hartuar Urdhrin Operativ "Rrjeta - 2018", përmes të cilit janë obliguar strukturat policore të nxjerrin plane për parandalimin, zbulimin dhe kapjen e kryesve të këtyre veprave.

Në aspektin formal, urdhrat - planet operative plotësojnë standardet sipas modelit pesë pikësh dhe përmbajnë informatat e duhura për trajtimin e grabitjeve. Në zbatimin e Urdhrit janë përfshirë një numër i madh njësisish, që në kuadër të aktivitetit të tyre kanë ndërmarrë një varg masash. Ka nevojë të shtimit të aktivitetit parandalues në sektorë patrullues, aty ku duket sikur nuk ka fokus të duhur, si rezultat edhe i kapaciteteve të kufizuara të burimeve njerëzore. Megjithëse planet parashohin shtim të patrullimeve dhe pikave të kontrollit, disa drejtori kanë reduktuar masat e tilla. Me iniciativë të nivelit qendror, në nivel rajonal janë angazhuar nga dy (2) punonjës me grada, që të monitorojnë implementimin e planeve dhe bashkërendimin e veprimeve në parandalim dhe hetim. Janë identifikuar aktivitete të PK-së, MPB-së, BQK-së, SHBK-së e kompanive të sigurimit për koordinim aktiviteteve parandaluese.

Koha e reagimit në vendin e ngjarjes apo në ndjekje të grabitësve vlerësohet të jetë brenda standardit, kurse njësitë policore në kuadër të DRP - Mitrovicë Jugu vlerësohet të kenë dalë më së shpejti në vendin e ngjarjes. Në disa logje të ngjarjeve ditore që lidhen me datat e ndodhjes së grabitjeve janë identifikuar informata të mangëta dhe formate të ndryshme të evidencës. Nga informata të azhuruara nga Sektorët Rajonal Hetimor, numri i grabitjeve me armë është më i ulët nga ai që paraqesin raportet inteligjente. Rreth 2/5 e numrit të përgjithshëm të rasteve të grabitjeve me armë janë proceduar në Prokuroritë kompetente me kallëzime penale me kryes të njohur, rreth 1/4 me kryes të panjohur, kurse nën hetime kanë mbeur rreth 1/3 e rasteve të raportuara gjatë vitit 2018. Me gjithë numrin e madh të rasteve nën hetim, DRP - Prishtinë ka proceduar numër më të madh të rasteve në Prokurori. Gjysma e Drejtorive kanë realizuar shkallë më të ulët të zbulimit të rasteve dhe procedimit të tyre në Prokurori.

Në disa dosje të rasteve, raporti i policit të parë në vendngjarje përmban informata të pakta dhe nuk përshkruan veprimet primare dhe sekondare të ndërmarra deri në ardhjen e njëjësive hetimore dhe të krim-technikës. Gjatë vlerësimit të veprimeve të njëjësive të krim-technikës në vendngjarje, skicimi i vendngjarjes nuk është zbatuar në disa raste. Janë identifikuar disa raste, ku fotografimi i vendit të ngjarjes nuk është zbatuar. Janë identifikuar situata kur skica e përgjithshme (kroki) dhe skica e detajuar nuk kanë qenë pjesë e dosjeve. Në të gjitha rastet që janë kontrolluar, Prokuroria ishte njoftuar me kohë për rastet e ndodhura penale. Plani i veprimit, sipas të cilit do të zhvillohet procesi hetimor për rastin, nuk është hartuar në një numër të konsideruar të rasteve. Duke parë shqetësimin e qytetarëve dhe bizneseve, si dhe me qëllim të ngritjes së sigurisë publike, rasteve të grabitjeve iu është dhënë prioritet.

Drejtoritë Rajonale vazhdimisht ballafaqohen me burime të pamjaftueshme njerëzore edhe pse mungesat e tilla janë menaxhuar mirë në zbatim të urdhrave - planeve operative. Janë evidente vështirësitë lidhur me automjetet dhe pajisjet e nevojshme. Luftimi efikas i krimit, përfshirë edhe grabitjet kërkon investim në teknologjinë e monitorimit përmes kamerave në rrugë dhe pjesë të qytetit, si zona të pambuluara që mund të jenë zona të përshtatshme për kriminelët. Programet trajnuese vlerësohen se janë të përshtatshme për të trajtuar veprat e grabitjeve me armë dhe veprave të ngjashme. Organizimi i trajnimeve të avancuara është i mirëseardhur për të ndjekur trendët e luftimit të kësaj dukurie.

Nga inspektimi kanë rrjedh gjashtë (6) rekomandime që i atribuohen gjetjeve. Me strukturën policore është arritur pajtim për përmbushjen e tyre sipas Planit të Veprimit. Për detaje mbi rekomandimet për këtë inspektim, më poshtë gjeni linkun e raportit të publikuar në ueb faqen zyrtare të IPK-së:

<http://ipk.rks-gov.net/wp-content/uploads/2019/05/Raportin-e-inspektimit-nr-01-2019.pdf>

Inspektimi nr. 02/2019:

Vlerësimi i respektimit të ligjshmërisë gjatë trajtimit të kundërshtimeve të palëve ndaj sanksioneve kundërvajtës

Më 01.07.2019, Kryeshefi Ekzekutiv ka kërkuar iniciimin e inspektimit të jashtëzakonshëm për të vlerësuar respektimin e ligjshmërisë nga struktura policore gjatë pranimit, shqyrtimit dhe vendosjes lidhur me kundërshtimet ndaj sanksioneve kundërvajtëse. Me Ligjin në fuqi, kundërvajtësve iu është mundësuar e drejta e kundërshtimit në Komisionin për Vendosje në kuadër të Policisë, ndaj sanksioneve kundërvajtës të shqiptuar nga policët. Janë evidentuar raste kur kundërvajtësit janë ndarë të pakënaqur me gjobat dhe trajtimin e kundërshtimeve



nga struktura policore. Vlerësimi i kësaj fushe paraqet interes për vlerësimin e ligjshmërisë në trajtimin e këtyre rasteve. Inspektimi është përqendruar në Komisionin për Vendosje të DKR-së. Janë zhvilluar intervista - takime me katër (4) punonjës dhe bartës të funksioneve, janë kryer inspektime fizike të funksionimit të SIPK-ut dhe evidencave dhe janë siguruar dhe kontrolluar 347 dosje të Komisionit që lidhen me trajtimin e kundërshtimeve.

Në kuadër të Policisë është i themeluar Organi kundërvajtës që trajton kundërshtimet ndaj sanksioneve kundërvajtës, gjegjësisht kundërshtimet që bien në domenin e tij. Kompetenca për trajtimin e këtyre kundërshtimeve përcaktohet me Ligjin për Kundërvajtje, të vërtetuar edhe me Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese mbi kushtetutshmërinë e disa neneve të këtij Ligji, në mesin e të cilëve edhe të nenit mbi kompetencat e Organit kundërvajtës. Ndërsa, sistemimi i këtij Organi (Komisionit për Vendosje) në kuadër të shtyllës ku operojnë njësitë e trafikut, si organe të shkallës së parë (të shqiptimit të kundërvajtjeve) është e nevojshme të rishikohet. Me gjithë faktin që Komisioni ka një bazë të gjërë ligjesh dhe aktesh nënligjore, në të cilat bazon punën, nevojitet rishikimi i akteve që rregullojnë kompetencat dhe fushë veprimtarinë e këtij Organi, për të qartësuar disa aspekte procedurale që janë identifikuar gjatë inspektimit. Komisioni ka një ngarkesë me raste dhe nevojitet ngritja e kapaciteteve. Krahas numrit të madh të rasteve, Komisioni ka arritur një kuotë të lartë të trajtimit të tyre.

Komisioni ka kapacitete profesionale për trajtim të kundërshtimeve dhe kompetencë lidhur me këtë. Jo në të gjitha trajtimet e kundërshtimeve, panelet janë udhëhequr nga anëtari me provim të jurisprudencës. Duhet eliminuar rastet e tilla, me gjithë faktin se brenda paneleve, njëri nga anëtarët ka të kryer provimin. Në të gjitha rastet e trajtimit dhe të shqyrtimit të kundërshtimeve, Komisioni për Vendosje ka vendosur brenda afateve të përcaktuara ligjore. Gjatë shqyrtimit dhe vendosjes lidhur me rastet, në disa prej tyre, ky Komision ka zbutur sanksionet kundërvajtëse bazuar në rrethana lehtësuese, si një e drejtë e rikonfirmuar nga një interpretim i Zyrës Ligjore të Ministrisë së Drejtësisë. Në shumicën e vendimeve jepen arsyet e aplikimit të rrethanave lehtësuese, duke iu referuar situatave të përcaktuara në nenin 31 e 35 të Ligjit. Është evidentuar numër i vogël rastesh kur vendimet nuk pasqyrojnë qartë këto situata. Nevojitet që në rastet e zbutjes së sanksionit kundërvajtës, arsyetimet të jenë të qartësuar. Ricilësimi i kundërvajtjeve nga Organi mbetet fushë që kërkon trajtim në të ardhmen dhe një definim në aspektin procedural.

Palëve të interesuara iu janë ofruar mundësi të ndryshme që të parashtrojnë kundërshtimet e tyre ndaj sanksioneve kundërvajtëse dhe për këtë, atyre iu janë lëshuar vërtetime për të dëshmuar pranimin - dorëzimin e tyre. Lidhur me kundërshtimet dhe palët mbahet evidencë e veçantë që përmban të dhëna relevante. Sa i përket dokumenteve të kërkuara nga palët, dosjet janë të kompletuara, ndërsa sa i përket shkresave dhe dokumenteve që nxirren nga Komisioni, në kuadër të dosjeve mungojnë procesverbalet e seancave. Vendimet e nxjerra përmbajnë elementet e nevojshme strukturore dhe formale, siç parashihet me ligjin në fuqi, kurse tek përmbajtja e arsyesimit, ato duhet të jenë më të artikulueshme në aspektin logjik.

Nga inspektimi kanë rrjedhë tre (3) rekomandime që i atribuohen gjetjeve. Me strukturën policore është arritur pajtim për përmbushjen e tyre sipas Planit të Veprimit. Për detaje mbi rekomandimet në këtë inspektim, më poshtë gjeni linkun e raportit të publikuar në ueb faqen zyrtare të IPK-së:

<http://ipk.rks-gov.net/wp-content/uploads/2019/11/RAPORT-INSPEKTIMI-NR-02-2019-Vler%C3%ABsimi-i-respektimit-t%C3%AB-ligjshm%C3%ABris%C3%AB-gjat%C3%AB-trajtim-t%C3%AB-kund%C3%ABrshtimeve-t%C3%AB-pal%C3%ABve-ndaj-sanksioneve-kund%C3%ABrvajt%C3%ABse.pdf>

Inspektimi nr. 03/2019:

Menaxhimi i buxhetit, financave, prokurimit dhe logjistikës

Plani Vjetor i Inspektimeve (2019) ka paraparë këtë inspektim dhe paraqet fushë me interes për IPK-në, me qëllim të vlerësimit nëse Policia është orientuar në shfrytëzimin racional e të drejtë të fondeve. Është e njohur se Policia është një shërbim publik me burime të shumta njerëzore, teknike dhe financiare. Shërbimet e sigurisë bartin kosto të lartë në disa kategori ekonomike. Shuma të mëdha financiare shpenzohen për paga, komunalitë, shërbime dhe mallra, në funksion të aktiviteteve operative, mbështetëse e projekteve kapitale. Inspektimi ofron mundësi për të vlerësuar kapacitetet menaxhuese, mënyrën si shpenzohen fondet dhe llogaridhënien. Inspektimi synon të vlerësojë nëse sistemi financiar, prokurues dhe logjistik është i ekspozuar ndaj rreziqeve që mund të kenë ndikim në suksesin dhe imazhin policor. IPK është interesuar të rishikojë nivelin e përmbushjes së rekomandimeve të dhëna në inspektimet e kaluara. Duke konsideruar se inspektimi është instrument i suksesshëm për të vlerësuar trajtimin e fushave, Kryeshefi Ekzekutiv më 25 mars 2019 ka iniciuar inspektim për të vlerësuar performancën policore në këto fusha. Ky inspektim është përqendruar në Departamentin e Shërbimeve Mbështetëse, përfshirë këtu Drejtorinë për Buxhet e Financa, Drejtorinë e Prokurimit dhe Drejtorinë e Logjistikës. Janë zhvilluar intervista dhe takime me së paku gjashtë (6) punonjës dhe bartës të funksioneve; janë kryer inspektime të bazave të të dhënave, depove, regjistrave dhe dosjeve të pagesave; si dhe janë kontrolluar 222 dosje të aktiviteteve financiare dhe të prokurimit.



Struktura organizative e Drejtorisë për Buxhet e Financa është funksionale, por ballafaqohet me mungesë të personelit në disa sektorë. Vërehen mospërputhje në disa raste të titujve të vendeve të punës, duke krahasuar vendimet për sistemimin e personelit me përshkrimet e vendeve të punës. Një shërbyes civil në këtë Drejtori nuk ka vendim në përputhje me punën që kryen. Shërbyesit civilë të kësaj Drejtorie kanë përgatitje universitare, janë të kualifikuar, por që në vitin e fundit nuk përfituan nga programet trajnuese. Në Drejtorinë e Prokurimit nuk është funksionale ndarja sektoriale. Detyra e Drejtorit ushtrohet nga Ushtrues detyre. Në disa raste, përshkrimet e vendeve të punës nuk përputhen me pozitat apo me vendet e punës. Shërbyesit civilë të kësaj Drejtorie kanë përvojë brenda fushës dhe janë të përfshirë në programe trajnuese të organizuara nga institucione përgjegjëse. Drejtorja e Logjistikës ka strukturë funksionale, por ballafaqohet me mungesë kapacitetesh në Bazën e Logjistikës. Shërbyesit civilë të Drejtorisë janë të hendikepuar në rrafshin e zhvillimit të vazhdueshëm profesional për shkak të mungesës së programeve trajnuese.

Drejtorja për Buxhet dhe Financa ka rol kryesor në përgatitjen e buxhetit. Përgatitja e draft buxhetit është realizuar brenda afateve kohore dhe procesi është përkrahur nga disa akterë, që kanë qenë pjesë e takimeve të shumta. Aktivitetet buxhetore janë përcjellur me dëgjime pranë Ministrisë së Financave. Viti 2018 ka shënuar një ngritje të theksuar të projeksioneve buxhetore në disa kategori ekonomike. Viti 2018 ka shënuar shkallë më të ulët të shpenzimit të buxhetit krahasuar me vitin paraprak. Me gjithë ngritjen e shpenzimeve të organizatës, komunalitë kanë shënuar rënie graduale në dy vitet e fundit. Në vitin 2018 shihet shkallë e

ulët e realizimit të projekteve kapitale. Kontrolli i avanseve për para të gatshme pasqyron raste të shpenzimit të mjeteve për furnizimet që mund të realizohen përmes kontratave me operatorët ekonomik, pasi që shpenzimet e tilla janë të parashikueshme. Është identifikuar një numër i madh avansesh për udhëtime zyrtare të mbyllura me vonesë. Shpenzimet për mbulimin e vendimeve gjyqësore janë dyfishuar. Drejtoria për Buxhet e Financa del të ketë qenë ekspeditive në ndërprerjen me kohë të financimit të pagave të punonjësve që iu është ndërprerë marrëdhënia e punës. Edhe pse të pakta në numër, janë evidentuar disa raste kur pagesat ndaj operatorëve ekonomik janë bërë përtej afateve. Dosjet për certifikim janë gjetur të kompletuara me dokumentacion.

Në dy vitet e fundit, planet e prokurimit janë përgatitur me kohë nga Autoriteti Kontraktues. Edhe pse kanë reduktuar ndarjen e kërkesave dhe prokurimet emergjente, planet nevojitet që të jenë më përmbajtësore, orientuese dhe joformale. Në drejtim të promovimit të transparencës, Drejtoria e Prokurimit mban një përmbledhje të rregulluar, gjithëpërfshirëse të të dhënave për secilin aktivitet të prokurimit. Kjo Drejtori ka përgatitur Raportet vjetore të kontratave publike të nënshkruara. Një numër i konsideruar i aktiviteteve të planifikuara të prokurimit nuk janë realizuar. Dosjet e prokurimit përmbajnë Deklaratat e Nevojave dhe Vendosshmërisë për Disponueshmërinë e Fondeve, por në disa raste nuk janë nënshkruar nga persona përgjegjës. Në procedurat e prokurimit janë evidentuar ende dobësi sa i përket respektimit të afateve kohore për përmbylljen me kohë të vlerësimit të tenderëve. Është identifikuar një rast kur nuk janë ndërmarrë hapat e nevojshëm për trajtimin e duhur të tenderit jo normalisht të ulët. Ka ende dobësi sa i përket hapave procedural në caktimin e menaxherëve të projekteve dhe nxjerrjen e planeve të menaxhimit të kontratave. Nevojitet avancim në fushën e planifikimit nga njësitë kërkuese, në mënyrë që kontratat të mos tejkalojnë vlerat e parashikuara. Janë identifikuar raste kur faturat ofrohen për pagesë në kundërshtim me kushtet kohore të pagesave të tyre. Penalizimet ndaj operatorëve që nuk respektojnë kushtet e kontratave kanë qenë evidente.

Në Drejtorinë e Logjistikës funksionon një proces i konsoliduar për trajtimin e procedimin e kërkesave initiale deri te administrimi i artikujve. Drejtoria është pjesë aktive e planifikimit, përgatitjes të specifikimeve dhe termave të referencës, vlerësimit të tenderëve, menaxhimit të kontratave dhe administrimit të stoqeve. Në dosjet e tenderëve dhe të pagesave janë pasqyruar kërkesat initiale për prokurim bashkë me sasinë e artikujve. Projektet e Drejtorisë duhet të jenë më cilësore, sidomos kur kemi të bëjmë me specifikimet dhe paramasat për kontratat kornizë. Vlerat dhe sasinë e parashikuara për arritjen e kontratave kornizë ka ndodhur që mos jenë të përafërta me nevojat. Sa i përket komisioneve të pranimit është lëvizur pozitivisht në drejtim të duhur dhe formohen nga autoriteti kompetent. Furnizimet e mostruara janë realizuar me komisione. Dosjet e mallrave të pranuar përmbajnë materien e nevojshme, përfshirë urdhër blerjet, fletë dërgesat, faturat dhe fletë inspektimit. Baza e Logjistikës ka përmirësuar evidencat, ngase në depon e uniformës, pajisjeve dhe inventarit, sasia e stokut përputhet me sasinë në evidencën fizike dhe elektronike. Pranë çdo artikulli ekziston regjistri fizik i hyrje - daljeve. Drejtoria ka eliminuar dukshëm kodet e shumëfishta të artikujve brenda bazës së të dhënave. Kjo bazë vazhdon të ketë vështirësi përshkak të mosmirëmbajtjes. Në depon e DMO-së, gjendja e regjistrave fizik të hyrje-daljeve përputhet me gjendjen e stokut në depo, por jo dhe me regjistrin elektronik.

Janë verifikuar disa nga furnizimet e realizuara dhe vërehet se artikujt në formë të pajisjeve, inventarit, automjeteve, etj, regjistrohen si pjesë e pasurive. Donacionet e institucioneve

vendore e atyre ndërkombëtare vlerësohen nga komisionet e vlerësimit dhe më pas bëhen pjesë e regjistrave të pasurive. Inventarizimet janë realizuar gjatë viteve të fundit, por Raporti i vitit 2017 është hartuar me vonesë. Inspektimi vë në pah se pasqyra e pasurive të vlerësuara për tjetërsim duhet të jetë e konsoliduar, përmbajtësore sa i përket informacionit për pasuritë e rekomanduara për tjetërsim.

Sistemi i vazhdueshëm i menaxhimit financiar dhe kontrollit realizohet përmes aktiviteteve të monitorimit, vet-vlerësimit dhe auditimit intern. Në vazhdën e monitorimit të MFK-së, Drejtori i Përgjithshëm në vitin 2018 ka nxjerrë Planin e Integritetit drejt identifikimit dhe përcaktimit të rreziqeve potenciale, por që deri në kohën e inspektimit nuk janë parë efektet lidhur me rishikimin e ndikimit të risqeve. Vet-vlerësimi si aktivitet që realizohet përmes pyetësorëve vetë-vlerësues është kryer gjatë viteve të fundit dhe brenda afateve është njoftuar Ministria e Financave. Edhe auditimi paraqet aktivitet të sistemit të vazhdueshëm të MFK-së dhe në këtë drejtim, Njësia e Auditimit ka hartuar Planin Strategjik dhe Vjetor të Auditimit mbi baza të vlerësimit të rrezikut dhe prioriteteve. Njësia ka përmbushur agjendën me Plan. Raportet e auditimit kanë identifikuar mangësi në sistemin e kontrollit intern, kanë nxjerrë përfundimet dhe kanë dhënë rekomandimet për përmirësimin e performancës. Përfaqësuesi i Policisë në Komitetin e Auditimit ka qenë pjesë e takimeve të mbajtura gjatë viteve të fundit, ku janë shqyrtuar gjetjet dhe rekomandimet.

Nga inspektimi kanë dalur 14 rekomandime, të cilat i atribuohen gjetjeve. Me strukturën policore është arritur pajtim për përmbushjen e tyre sipas Planit të Veprimit. Nga inspektimi ka rezultuar se nga nëntë (9) rekomandime të lëna në inspektimin e kaluar nga fusha e prokurimit, shtatë (7) prej tyre janë realizuar plotësisht dhe dy (2) përgjithësisht. Kurse, nga katër (4) rekomandime të lëna në inspektimin e kaluar nga fusha e logjistikës, një (1) prej tyre është realizuar plotësisht dhe tre (3) përgjithësisht. Për detaje lidhur me rekomandimet për këtë inspektim, më poshtë gjeni linkun e raportit të publikuar në ueb faqen zyrtare të IPK-së:

<https://ipk.rks-gov.net/wp-content/uploads/2019/12/RAPORTI-I-INSPEKTIMIT-NR.-04-2019-MENAXHIMI-I-BUXHETIT-FINANCAVE-PROKURIMIT-DHE-LOGJISTIK%C3%8BS.pdf>

Inspektimi nr. 04/2019:

Menaxhimi i patrullimeve dhe sigurisë në rrugë



Plani Vjetor ka paraparë këtë inspektim dhe paraqet fushë me interes për IPK-në me qëllim të vlerësimit nëse Policia ka kapacitete ligjore, njerëzore dhe teknike për të përmbushur detyrat dhe përgjegjësitë e përcaktuara me ligj. Përmes inspektimit verifikohet gjendja dhe kryerja e detyrave policore në menaxhimin e sigurisë në rrugë në harmoni me kriteret ligjore në fuqi dhe jepen rekomandime për përmirësim. Duke konsideruar se inspektimi paraqet një instrument të suksesshëm për të vlerësuar trajtimin e fushës, Kryeshefi Ekzekutiv i IPK-së më 06.06.2019 ka iniciuar inspektim për të vlerësuar angazhimet policore në përmbushjen e obligimeve që dalin nga ligjet në fuqi dhe Strategjia për Siguri Rrugore. Inspektimi është përqendruar në DKRR, NJKA dhe NJRKR. Janë zhvilluar

intervista - takime me së paku dhjetë (10) punonjës dhe bartës të funksioneve; janë kryer inspektime fizike të SIPK-ut, evidencave dhe metodave të punës; janë siguruar e kontrolluar rreth 180 dosje aksidentesh.

Në drejtim të ngritjes së sigurisë së përgjithshme në trafik, Policia realizon patrullime në të gjitha rrugët përmes njësive patrulluese, të cilat fushëveprimin e kanë të ndarë në zona të përgjegjësive. Janë bërë hapa pozitiv në stabilizimin e strukturës me burime njerëzore, por ende duhet angazhim, ngase janë edhe disa njësi që kanë mungesë - tejkalim të numrit të punonjësve. Në disa njësi nuk janë funksionalizuar ende Ekipet e motoçiklistëve. Trajnimet e brendshme janë realizuar me një kuotë jo të kënaqshme të orëve të mbajtura nga shumica e njësive të trafikut. Aplikimi i përdorimit të automjeteve me targa civile ka sjellë risi, si një metodë efikase në ngritjen e sigurisë në rrugë.

Njësitë e trafikut kanë pajisje të mjaftueshme funksionale për matjen e prezencës së alkoolit në gjak tek pjesëmarrësit në trafik, por shqetësuese mbetet fakti se çdo e treta pajisje në pronësi është jofunksionale. Pajisjet e tilla të trafikut që janë gjetur në gjendje funksionale gjatë inspektimit, kanë qenë të kalibruara. Përgjithësisht njësitë janë të pajisura me matës funksional të shpejtësisë së lëvizjes së mjeteve motorike, por është shqetësues fakti se rreth 60% e pajisjeve në pronësi janë jofunksionale. Veç pajisjeve teknike që janë të nevojshme për punë, njësitë e trafikut rrugor kanë nevojë edhe për kushte më të mira pune, ngase janë identifikuar nevoja për përmirësimin e gjendjes aktuale, meqë ka mungesë të kompjuterëve, printerëve, automjeteve dhe hapësirave për punë. Në drejtim të ngritjes së integritetit policor dhe cilësisë në punë, viteve të fundit janë realizuar inspektime në njësitë e trafikut nga tre nivelet mbikëqyrëse, me gjithë faktin se ato kanë një trend rënës në vitin e fundit.

Parametrat mbi gjendjen e sigurisë në raport me pritjet e Strategjisë për Siguri Rrugore nuk japin sinjal se deri në vitin 2020 do të përgjysmohet shkalla e fataliteteve dhe reduktohet ajo e të lënduarve për 20%. Kosova mbetet e renditur larg mesatares së vdekshmërisë që është në vendet e Bashkimit Evropian, por qëndron më mirë se disa vende të rajonit. Nga të gjitha parashikimet, një parametër mbi sigurinë rrugore ka një trend pozitiv - rënia e numrit të aksidenteve. Ngritja e masave parandaluese nuk ka rezultuar me zvogëlimin e fataliteteve dhe të të lënduarve, duke vërtetuar kështu se gjendja e sigurisë rrugore nuk po varet vetëm nga angazhimi policor, por edhe nga akterë tjerë dhe qytetarët. Përgjithësisht në vitin 2018 ka shënuar ngritje numri i patrullimeve, pikave të kontrollit dhe i gjobave të shqiptuara.

Njësive të trafikut u është lejuar aplikimi i masave mbrojtëse dhe shqiptimi i pikëve negative gjatë sanksionimit të kundërvajtësve, gjë që edhe është duke ndodhur në praktikë. MPB ka nxjerrë një Udhëzim Administrativ për procedurën e kundërvajtjes, i cili ka kolizion në mes neneve dhe me Ligjin në fjalë. Njësitë e trafikut po konfiskojnë patentë shoferët dhe kjo po kundërshtohet nga palët, kurse inspektorët vlerësojnë se nuk ekziston qasje e duhur ndaj kësaj çështjeje. Janë vërejtur raste kur të dhënat në SIPK janë futur pa kaluar afatet, brenda të cilave mund të ushtrohen kundërshtime, si dhe ende pa u bërë të plotfuqishme vendimet. Patentë shoferët e konfiskuar mbahen në Polici në kundërshtim me Udhëzimin, ngase ato nuk dorëzohen në organin kompetent që i ka lëshuar. Është vërejtur në disa raste kur policët patrullues nuk e shqiptojnë të plotë gjobën dhe përcillet me dhënie vetëm të gjobës në të holla, por jo edhe me aplikim të masës mbrojtëse dhe pikëve negative. Gjatë kontrollit të tahografëve, ka situata kur policët nuk lëshojnë vërtetim për leximin e tahografëve. Vërehet mungesë e pajisjeve përkatëse që lexojnë tahografët digjital.

Shumë nga dosjet e aksidenteve nuk kanë raportin e policit në vendngjarje, kurse shumica e dosjeve pasqyrojnë përfshirje të skicave të vendit të ngjarjes në kuadër të tyre. Deklaratat e marra nga pjesëmarrësit e aksidenteve në shumicën e rasteve nuk janë unike në të gjitha njësitë dhe nuk janë shumë përmbajtësore ngase u mungojnë pyetjet e parashtruara. Numri i deklaratave është i vogël dhe nuk ka përfshirje edhe të pasagjerëve e dëshmitarëve tjerë. Pajisjet për matjen e prezencës së alkoolit në gjak tek pjesëmarrësit e aksidenteve të trafikut nuk përdoren në të gjitha rastet dhe në vitin 2018, afërsisht në çdo të katërtin rast janë përdorur ato. Dosjet e rasteve të aksidenteve përmbajnë kallëzimet penale të ngritura, por ka nevojë për një format unik në nivel të të gjitha njësive të trafikut.

Patrullat janë gjetur në zonat e përgjegjesisë sipas orareve të përcaktuara. Me gjithë faktin se njësitë e trafikut janë të pajisura me alkooteste, terreni ka pasqyruar një situatë ndryshe, ngase shumë pak patrulla kanë pasur pajisjen e tillë gjatë patrullimit. Patrullat që janë hasur në terren kanë pasur mungesa të koneve numerik, materialit shpenzues dhe dokumenteve. Janë evidentuar situata kur patrullat policore kanë ndalur më tepër se dy automjete për kontroll, kanë neglizhuar rregullat e sigurisë për qëndrim në gjendje gatishmërie dhe në disa raste janë vërejtë kundërvajtës duke qëndruar tek automjetet policore.

Nga inspektimi janë dhënë 15 rekomandime, të cilat i atribuohen gjetjeve. Me strukturën policore është arritur pajtim për përmbushjen e tyre sipas Planit të Veprimit. Nga inspektimi ka rezultuar se nga gjashtë (6) rekomandime të lëna në inspektimin e kaluar, një (1) është realizuar plotësisht, katër (4) përgjithësisht dhe një (1) nuk është vlerësuar për shkak se fusha përkatëse nuk ka qenë objekt inspektimi. Për detaje tjera lidhur me rekomandimet për këtë inspektim, gjeni linkun e raportit të publikuar në ueb faqen zyrtare të IPK-së:

<http://ipk.rks-gov.net/wp-content/uploads/2019/11/Raport-i-inspektimit-mbi-menaxhimin-e-patrullimeve-dhe-siguris%C3%AB-n%C3%AB-rrug%C3%AB.pdf>

Inspektimi nr. 05/2019:

Menaxhimi i ruajtjes dhe kontrollit të kufirit dhe migracionit

Plani Vjetor i Inspektimit ka paraparë këtë inspektim dhe paraqet një fushë me interes për me qëllim të vlerësimit nëse Policia ka kapacitete të mjaftueshme teknike dhe njerëzore për ruajtjen e kontrollin e kufirit, për të lehtësuar qarkullimin e lirë të njerëzve dhe mallrave, për të siguruar kufij të hapur dhe të sigurt, për të luftuar krimin ndërkuftar, për të përmbushur objektivat strategjik në menaxhimin e integruar të kufirit dhe për të kontrolluar migracionin. IPK-ja është interesuar të rishikojë edhe nivelin e përmbushjes së rekomandimeve të kaluar.

Kryeshefi Ekzekutiv më 06.06.2019 ka iniciuar një inspektim për të vlerësuar performancën policore në këtë fushë, i cili është përqendruar në Departamentin për Kufi. Janë zhvilluar intervista - takime me së paku 21 punonjës dhe bartës të funksioneve; janë kryer verifikime fizike të pajisjeve, ekipeve, masave të sigurisë dhe sistemeve; janë plotësuar formularët për verifikim; janë siguruar dhe kontrolluar 68 dosje të aktiviteteve të njësive policore kufitare.



Patrullat kufitare janë gjetur në përbërje të plotë, me një ndarje të duhur të roleve dhe në respektim të orarit. IPK-ja është ndarë e kënaqur me transmetimin e informacionit nga ndërrimi në ndërrim dhe raportimin nga udhëheqësit. Komunikimi nga terreni nga patrullat në disa raste është i vështirësuar dhe larg pritjeve, për arsye objektive dhe subjektive. Procedura e pranimit - dorëzimit të armëve të gjata aplikohet në të gjitha stacionet, por ka nevojë që në disa prej tyre, informatat mbi procedurën të jenë më të plota. Përgjithësisht në nivel vendi ka shtim të disa nga masat e kontrollit kufitar përgjatë vijës kufitare, përfshirë patrullimet me automjet, patrullimet në këmbë dhe pikat e kontrollit. Gjatë vitit në disa periudha, SPK-të kanë aplikuar masat e lehtësimit kufitar për shkak të fluksit të qytetarëve dhe automjeteve. IPK-ja është ndarë e kënaqur me organizimin dhe funksionimin e kontrollit të vijës së parë dhe të dytë të realizuar nga SPK-të. Numri i kontrolleve të personave dhe automjeteve në Pikat e Kalimit përgjithësisht në nivel vendi ka shënuar ngritje krahasuar me vitet e fundit. Vërmica dhe Hani i Elezit vazhdojnë të mbesin pikat më të frekuentuara dhe mbajnë primatin për numrin më të madh të kontrolleve në raport me numrin e policëve. Numri i kontrolleve të personave në vijën e dytë në nivel vendi ka shënuar ngritje. Merdare ka përqindjen më të lartë të kontrolleve të realizuara në raport me numrin e personave të kontrolluar në vijën e parë. Ngritje ka shënuar edhe numri i kontrolleve të automjeteve në vijën e dytë, kurse Kulla dhe Jarinje kanë realizuar përqindjen më të lartë të kontrolleve në raport me numrin e automjeteve të kontrolluara në vijën e parë.

Në drejtim të zhvillimit të konceptit të MIK-ut në arritjen e objektivit për kufi të sigurt dhe të kontrolluar, Departamenti për Kufi ka shtrirë bashkëpunimin në tre nivele bashkëpunimi: në nivel autoriteti, me autoritetet vendore në kuadër të MIK-ut dhe në rrafshin ndërkombëtar. Statistikat evidente nuk pasqyrojnë trende të kënaqshme dhe duhet analizuar indikatorët që pasqyrojnë angazhimet në tre rrafshet dhe të identifikohen shkaqet që kanë për rrjedhojë rezultatet jo të kënaqshme në frymën e bashkëpunimeve. Bashkëpunimi me FRONTEX-in po konsiderohet i frytshëm në nivel të përfshirjes në takimet e organizuara dhe në misionet për kontroll të kufijve të jashtëm të Shengenit dhe aeroporte të vendeve të Shengenit. Analiza dhe vlerësimi i riskut realizohet në nivelin strategjik, operacional dhe atë taktik. Në luftimin e krimit ndërkufitar, njësitë hetimore kanë trajtuar rastet e iniciuara, numri i të cilave në nivel departamenti në dy vitet e fundit është afërsisht i baraspeshuar dhe afërsisht gjysma e tyre janë kategorizuar vepra penale dhe gjysma si kundërvajtje. Lindja dhe Perëndimi kanë shënuar numrin më të madh të veprave penale dhe kundërvajtjeve në dy vitet e fundit. Kontrolli i dosjeve hetimore vë në pah praktikë të papranueshme të mirëmbajtjes së tyre, meqë nuk përmbajnë tërë dokumentet e përcaktuara me procedurat në fuqi dhe kjo shtron nevojën për ushtrimin e një kontrolli më rigoroz ndaj njërive.

Në vitin e fundit janë evidentuar më pak raste të refuzimit të hyrjes së shtetasve të huaj. Nuk është hasur të ketë lëvizur ndonjë shtetas i huaj brenda territorit tonë përmes Pikave të Kalimit Kufitar, që nuk përmbushë kriteret për hyrje. Gjatë kontrollit të dosjeve të largimeve të shtetasve të huaj janë vërejtur mungesa të theksuara të dokumenteve, andaj kjo praktikë është e papranueshme dhe nevojitet kontroll i shtuar në eliminimin e dobësive. Numri i vizave të lëshuar në Pikë Kalime është simbolik, për to mbahen evidenca dhe janë lëshuar në përputhje me kriteret e përcaktuara. Me kërkesë të MPJ-së, DMH-ja ka kryer verifikime të gjendjes faktike të aplikuesve të vizave në misione diplomatike e konsullore të vendit tonë dhe brenda afateve kohore ka kthyer raportet e verifikimit me rekomandime. Raportet me rekomandime negative kanë shënuar një rënie në vitin 2018 krahasuar me një vit më parë. Dosjet e verifikimit janë të kompletuara dhe përmbajnë kërkesat dhe raportet verifikuese.

Trajtimi fillestar i azilkërkuesve vlerësohet i realizuar konform standardeve të përcaktuara. Dosjet e rasteve janë të kompletuara dhe i janë dorëzuar DSHAM-it brenda afateve.

IPK-ja ka gjetur një gjendje më të kënaqshme sa i përket kapaciteteve të angazhuara të burimeve njerëzore, me gjithë tejkalimet e mungesat në disa pjesë strukturore. Vazhdon të ketë shpërputhje sa i përket personelit të graduar në një numër pozitash, meqë ka ende raste kur pozitat ushtrohen nga punonjës me grada jo adekuate. Në drejtim të avancimit të njohurive dhe shkathtësive të personelit, vërehet ecje pozitive në përmbushjen e agjendës në trajnimet e brendshme, ngase ka përfshirje më të gjerë të personelit. Ka hapa inkurajues në aplikimin e Strategjisë Antikorrupsion dhe kjo është pozitive në ngritjen e integritetit policor, ngase lëvizja e personelit minimizon mundësitë për abuzime. Kontrolllet e kualitetit paraqesin aktivitet me rëndësi në ngritjen e cilësisë së punës, kanë identifikuar vështirësitë dhe sfidat, por në të ardhmen duhet të prekin edhe hetimet. Përgjatë vijës kufitare janë vendosur sisteme monitorimi dhe ato paraqesin mundësi për një kontroll të avancuar. Ato u shërbejnë patrullave që të kenë nën vëzhgim pika të nxehta të vijës kufitare për ndonjë aktivitet të mundshëm kriminal. Gjendja me automjete policore është e rënduar, si dhe e papërmirësuar. Është evidentuar mungesë dhe jofunksionalitet i një numri pajisjesh policore në SPK/SPMK, me çka mund të vështirësohet puna efektive e njësive. Sistemi i Menaxhimit Kufitar vlerësohet të jetë funksional në të gjitha PKK-të. Stop Lista është funksionale në kuadër të SMK-së, por ende ka probleme me freskimin e të dhënave si pasojë e komunikimit jo azhur dhe vonesave në pranimin e vendimeve gjyqësore. Në disa SPK duhet shtuar masat e sigurisë për ruajtjen e serverëve, duke u përkujdesur që të jenë të mbrojtur. Kushte më të mira të ruajtjes nevojitet edhe për vulat në disa nga SPK-të.

Nga inspektimi kanë dalur 13 rekomandime, të cilat i atribuohen gjetjeve. Me strukturën policore është arritur pajtim për përmbushjen e tyre sipas Planit të Veprimit. Nga inspektimi i kryer ka rezultuar se nga tetë (8) rekomandime të lëna në inspektimin e kaluar, një (1) prej tyre është përmbushur plotësisht, pesë (5) përgjithësisht, një (1) pjesërisht dhe një (1) nuk është përmbushur. Për detaje tjera lidhur me rekomandimet për këtë inspektim, më poshtë gjeni linkun e raportit të publikuar në ueb faqen zyrtare të IPK-së:

<https://ipk.rks-gov.net/wp-content/uploads/2019/12/RAPORT-I-INSPEKTIMIT-MBI-MENAXHIMIN-E-RUAJTJES-DHE-KONTROLLIT-TE-KUFIRIT-.pdf>

Inspektimi nr. 06/2019:

Menaxhimi i hetimit dhe zbulimit të krimit, si dhe administrimit të rasteve

Plani Vjetor i Inspektimit ka paraparë këtë inspektim dhe paraqet fushë me interes për IPK-në me qëllim të vlerësimit nëse Policia është e përkushtuar që të parandalojë, hetojë dhe zbulojë krimet, si dhe të reduktojë nivelin e kriminalitetit siç parashihet në planet strategjike në drejtim të forcimit të sundimit të rendit dhe ligjit. IPK është interesuar të rishikojë edhe nivelin e përmbushjes së rekomandimeve nga inspektimi i kaluar. Kryeshefi Ekzekutiv më 10 korrik 2019 ka iniciuar një inspektim për vlerësuar performancën policore në këtë fushë, i cili është përqendruar në Sektorët Rajonal të Hetimeve të DRP - ve. Janë zhvilluar intervista-takime me së paku 16 punonjës dhe bartës të funksioneve; janë kryer verifikime fizike të evidencave, mostrave të dëshmvive, kushteve fizike dhe të sigurisë në dhomat e dëshmvive; si dhe janë kontrolluar 80 dosje.



Një numër i dosjeve penale nuk kanë Raport policor njoftues për Prokurorin e Shtetit. Janë identifikuar një mori lëndësh, në të cilat nuk është respektuar zinxhiri komandues për t'iu nënshtruar kontrollit dhe nënshkrimit nga mbikëqyrësit. Formularët e përdorur brenda dosjeve penale nuk janë unik në kuadër të sektorëve dhe nuk ka një standard të aplikuar të hartimit të shkresave të lëndëve. Në disa dosje penale janë gjetur deklarata që nuk i përmbajnë të drejtat e rezervuara të palëve.

Në disa deklarata që i përmbajnë të drejtat e rezervuara, ato nuk janë konform Kodit të Procedurës Penale. Ka deklarata të panënshkruara nga marrësit e tyre, të dyshuarit apo dëshmitarët e intervistuar. Kallëzimet penale plotësojnë kriteret bazike dhe përmbajnë elemente të nevojshme përmbajtësore për t'u dorëzuar në Prokurori. IPK çmon angazhimet policore në respektimin e dispozitave mbi përfaqësimin e avokatit në rastet kur prania e tij ka qenë e domosdoshme gjatë marrjes së deklaratës së të dyshuarit.

Matja e efikasitetit dhe performances së njësive rajonale është sfiduar përshkak mungesës së të dhënave mbi lëndët e bartura penale nga vitet e kaluara. Raportet vjetore të DRP-ve nuk pasqyrojnë numrin e përgjithshëm të këtyre lëndëve, andaj IPK ka matur performancën e efikasitetin vetëm për lëndët e iniciuara gjatë viteve të fundit. Ky problem shtrun nevojën për një rishikim të politikave aktuale mbi pasqyrimin më të plotë të të dhënave mbi krimin dhe statusin e rasteve. Numri i veprave penale në kompetencë të Sektorëve Rajonal ka rënë në vitin 2018 krahasuar me një vit më parë, kurse hetuesit rajonal të Prishtinës kanë pasur ngarkesë më të madhe me raste krahasuar me hetuesit e sektorëve tjerë. Zbulueshmëria ka shënuar një ngritje gjatë vitit 2018 prej 3% krahasuar me një vit më parë. Marrë parasysh dy vitet krahasimore, del se Ferizaj (2017) dhe Gjakova (2018) kanë realizuar shkallë më të lartë të zbulueshmërisë, derisa Prizreni (2017) dhe Prishtina (2018) kanë realizuar shkallë më të ulët. Përgjithësisht në vitin 2017 rezultojnë një raport 1 me 2 i numrit të rasteve të pazbuluara karshi atyre të zbuluara, derisa në vitin 2018, ky raport sillet në 1 me 3 në favor të numrit të rasteve të zbuluara. Gjatë vitit 2017 tek Ferizaj, raporti rezultojnë të jetë 1 me 7 në favor të numrit të rasteve të zbuluara, derisa tek Prizreni është 1 me 0.4 në favor të numrit të rasteve të pazbuluara. Gjatë vitit 2018, tek Gjakova ky raport rezultojnë të jetë 1 me 14, derisa tek Prishtina dhe Gjilani rezultojnë të jetë 1 me 2 në favor të rasteve të zbuluara.

Disa nga Dhomat e dëshmitëve në kuadër të drejtorive nuk kanë përmbushur disa nga kriteret për trajtimin e duhur të dëshmitëve. Në disa raste, për shkak të specifikave të tyre, dëshmitë nuk ruhen të ndara në vende të posaçme. Janë evidentuar raste ku paratë nuk ruhen brenda zonës së deponimit, si dhe kur mostrat biologjike nuk ruhen në frigorifer. Në të shumtën e rasteve, dëshmitë janë identifikuar lehtë, por jo në të gjitha rastet ato janë paketuara dhe shënuar në mënyrën e duhur. Vërehet në disa raste mungesë e të dhënave mbi lëvizjet e dëshmitëve në zinxhirët e ruajtjes dhe në regjistra. Duhet përmirësuar gjendja në mbajtjen e evidencave më të plota të dëshmitëve. Duhet ngritur vëmendja që në rastet e hapjes së dëshmitëve të respektohet procedura e regjistrimit special. Duhet ndërmarrë masa për ngritje të sigurisë së dëshmitëve, duke shfrytëzuar zona të përshtatshme brenda hapësirave të deponimit për vendosjen e llojeve të caktuara të dëshmitëve. Duhet kushtuar kujdes rregullit

mbi të drejtën e personave të autorizuar që të mbajnë çelësat e Dhomave të dëshmime për të pamundësuar qasjet e paautorizuara.

Niveli i sigurisë në Dhomat e dëshmime në DRP duhet avancuar dhe kjo nisët nga fakti se sistemet e alarmit, video mbikëqyrjes dhe detektimit të tymit ndryshojnë sipas dhomave. Ka Dhoma të dëshmime që kanë sisteme të tilla funksionale, disa nga to edhe pse i kanë të instaluar, ato nuk janë funksionale, por ka edhe prej tyre që fare nuk i kanë sistemet e tilla. Disa Dhoma që kanë probleme me lagështinë janë vendosur në hapësira të papërshtatshme. Në Gjilan dëshmitë ruhen në kushte të papërshtatshme për shkak të nivelit të lartë të lagështisë. Dëshmitë janë të rrezikuara nga dëmtimi, prishja e kontaminimi. Mospërdorimi i frigoriferëve dhe mungesa e frigoriferëve adekuat ka bërë që në disa Dhoma të dëshmime, dëshmitë të ruhen në vende jo adekuate, gjë që kjo duhet evituar. Në shumicën e Dhomave të dëshmime nuk janë kryer revizione, inventarizime dhe inspektime, kurse në disa prej tyre, ato nuk janë realizuar në baza të rregullta periodike.

Janë dhënë 12 rekomandime, të cilat i atribuohen gjetjeve. Nga 12 rekomandime të lëna në inspektimin e kaluar, dy (2) prej tyre janë përbushur plotësisht, tre (3) përgjithësisht, katër (4) pjesërisht dhe tre (3) rekomandime nuk janë vlerësuar për shkak se nuk kanë qenë objekt inspektimit. Për detaje tjera lidhur me rekomandimet për këtë inspektim, më poshtë gjeni linkun e raportit të publikuar në ueb faqen zyrtare të IPK-së:

<https://ipk.rks-gov.net/wp-content/uploads/2020/01/RAPORTI-I-INSPEKTIMIT-NR.-06-2019-MENAXHIMI-I-HETIMIT-DHE-ZBULIMIT-T%C3%8B-KRIMIT-SI-DHE-ADMINISTRIMI-I-RASTEVE.pdf>

DEPARTAMENTI PËR PLANIFIKIM, BASHKËPUNIM, ÇËSHTJE LIGJORE DHE INFORMIM

**Ne u angazhuam në
senzibilizimin e
qytetarëve për të
shprehur përkushtimin
tonë për trajtimin e
shqetësimeve të tyre:**

- Publikuam mbi **50** komunikata,
- Ofruam informacione për medie në mbi **300** kërkesa të tyre;
- Realizuam mbi **15** takime me qytetarë, forume të sigurisë, OJQ, institucione, etj;
- Hartuam dokumente planifikuese dhe akte nënligjore;
- Finalizuam një marrëveshje ndërkombëtare për bashkëpunim dhe marrëm pjesë në shumë forume dhe konferenca.

8. PLANIFIKIMI STRATEGJIK, ÇËSHTJET LIGJORE, MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN, PROMOVIMI DHE BASHKËPUNIMI

Departamenti për Planifikim, Bashkëpunim, Çështje Ligjore dhe Informim është një ndarje organizative në kuadër të strukturës së organizimit të IPK-së dhe si i tillë funksionon nga viti 2017.

Përgjegjësitë (detyrat) e këtij Departamenti janë: udhëheqë aktivitetet në nxjerrjen e planeve strategjike, bazuar në objektivat strategjike të Ministrisë, si dhe vlerëson zbatimin e planeve për përmbushjen e objektivave strategjike; siguron shërbime juridike / këshilluese ligjore për të siguruar menaxhim efektiv të rreziqeve ligjore dhe kontraktuale; udhëheqë aktivitetet për nxjerrjen, rishikimin - plotësimin e udhëzimeve, rregulloreve dhe PSO-ve lidhur me funksionet e IPK-së; udhëheqë me aktivitetet në zhvillimin dhe avancimin e bashkëpunimit e partneritetit ndër institucional brenda dhe jashtë vendit; udhëheqë aktivitetet e organizatës në ofrimin e shërbimeve profesionale në fushën e komunikimit dhe informimit publik; udhëheqë me aktivitetet për të siguruar realizimin e politikave në promovimin e vlerave, me qëllim të ngritjes së besimit dhe fuqizimit të rolit mbikëqyrës të IPK-së¹⁹.

DPBÇLI zhvillon aktivitetin në dy (2) divizione:

- Divizionin për Planifikim dhe Çështje Ligjore;
- Divizionin për Bashkëpunim dhe Informim.

Departamenti ka të punësuar gjashtë (6) punonjës.

¹⁹Neni 21 i Rregullores (MPB) nr. 01/2017 (Departamenti për Planifikim, Bashkëpunim, Çështje Ligjore e Informim)

IPK-ja gjatë vitit 2019 është angazhuar në përmbushjen e detyrave që kanë dalë nga Plani Zhvillimor Strategjik 2019 - 2021 dhe detyra të tjera sipas nevojave. Aktivitetet në fushën e marrëdhënieve me publikun, bashkëpunimit vendor e ndërkombëtar, planifikimit strategjik dhe çështjeve ligjore, IPK i ka realizuar përmes Departamentit për Planifikim, Bashkëpunim, Çështje Ligjore dhe Informim.

DPBÇLI është angazhuar në aspektin e planifikimit strategjik duke përgatitur Planin Vjetor dhe Planin e Veprimit, pastaj përgatitjen dhe azhurnimin e Listës së Analizës së Riskut për IPK-në, finalizimin e Procedurave Standarde të Operimit për Menaxhimin e Ankesave dhe Hetimeve, etj. Angazhimet e DPBÇLI-së janë fokusuar edhe në fuqizimin e bashkëpunimit me qytetarë, institucione vendore dhe ndërkombëtare.

a) Bashkëpunimi me institucionet vendore

Në kuadër të bashkëpunimit vendor, DPBÇLI kanë pasur aktivitete me rëndësi në fuqizimin e këtij bashkëpunimi. Si pikë e kontaktit me institucionet vendore, janë trajtuar të gjitha kërkesat që kanë ardhur në adresën e IPK-së. Në bashkëpunim me departamentet e tjera, janë kthyer përgjigjet në MPB mbi raportimet për përmbushjen e objektivave strategjike të Planit të MPB-së dhe Qeverisë. DPBÇLI ka trajtuar të gjitha kërkesat për qasje në dokumente publike, si dhe ka raportuar te Zyra e Kryeministrit mbi numrin e kërkesave të trajtuara.



Në kuadër të angazhimeve me institucionet e tjera, është ngritur niveli i bashkëpunimit me Avokatin e Popullit për fushën e të drejtave e lirive të njeriut. DPBÇLI ka trajtuar kërkesat që kanë ardhur nga ky institucion, respektivisht nga Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës. Janë trajtuar kërkesat e ardhura nga Avokati i Popullit, përfshirë edhe kërkesat për hapjen e rasteve sipas detyrës zyrtare.

Gjatë punës së përditshme, punonjësit e strukturës hetimor krijuar lidhje bashkëpunimi në drejtim të luftimit të korrupcionit penale. Kjo ka ndikuar që IPK dhe Prokuroria e Shtetit bashkëpunimit në luftimin e dukurive negative, të cilat hasen Policisë, e në veçanti në luftimin e korrupsionit, përmes shprehjes së dyshimit dhe implikimit në veprimtari penale të zyrtarëve policor.



Bashkëpunimi me Policinë është i orientuar në dhënien e kontributit për ngritjen e performancës së dy agjencive dhe ofrimin e ndihmës reciproke, teknike, operative dhe mbështetëse. Në bashkëpunim me Policinë, IPK ka bërë instalimin dhe konfigurimin e nevojshëm për rrjetin e brendshëm të Policisë në IPK, ku zyrtarët e IPK-së do të shfrytëzojnë qasjet në sistemet dhe bazat e të dhënave policore për të kryer verifikimet e nevojshme.

Varësisht prej nevojave operative në terren, në bashkëpunim me departamentet tjera në IPK, janë publikuar komunikata për media dhe janë organizuar takime ku janë pasqyruar rezultatet e arritura nga IPK. Aktivitetet e realizuara nga IPK-ja gjatë vitit 2019 në drejtim të fuqizimit të transparencës dhe bashkëpunimit me qytetarë përfshijnë:

- Publikimin e rasteve që zgjojnë interesin e opinionit publik (kryesisht përmes komunikatave për medie);
- Dhënien e deklaratave për mediet;
- Angazhimet shtesë në fushën e marrëdhënieve me publikun;
- Dhënien e përgjigjeve palëve dhe ofrimin e qasjeve në kërkesat për qasje në dokumente publike;
- Dhënien e përgjigjeve në kërkesat e adresuara nga mediet e ndryshme në çështjet që kanë të bëjnë me aktivitetet e IPK-së, etj.

DPBÇLI ka administruar dhe përditësuar informatat në rrjetet sociale, me fokus të veçantë në Facebook-un zyrtar. Secila komunikatë që është përcjellë për publikim në ueb faqen zyrtare, është publikuar edhe në Facebook, duke rritur kështu edhe numrin e ndjekësve.

b) Publikimi i revistës “Integriteti”

Ndër angazhimet e IPK-së në vitin 2019 për fuqizim të transparencës ka qenë edhe publikimi i revistës së rregullt “Integriteti”. Përveç informimit të brendshëm dhe atë kryesisht përmes shkrimeve të ndryshme të botuara në revistën zyrtare të IPK-së, kjo revistë konsiderohet si një projekt i rëndësishëm edhe për informimin e jashtëm e sidomos të zyrtarëve policor, partnerëve dhe qytetarëve për angazhimet e IPK-së.

c) Aktivitete me qytetarë lidhur me misionin e IPK-së dhe Linjës së Kaltër

DPBÇLI në bashkëpunim me ICITAP-in, forumet e sigurisë dhe akterët tjerë ka realizuar aktivitete të shumta në fushën e bashkëpunimit me qytetarë, duke prezantuar para tyre rolin, misionin dhe objektin e veprimtarisë së IPK-së. Një aktivitet i tillë me temën “Inspektorati Policor i Kosovës, roli dhe rëndësia në sundimin e ligjit në Kosovë” është mbajtur me qytetarë të komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian në Qendrën “Fidan Lahu” në Fushë Kosovë, ku kanë marrë pjesë qytetarë të moshave të ndryshme. Ky aktivitet është realizuar në bashkëpunim me ICITAP-in, Kuvendin Komunal të Fushë Kosovës dhe EVSB-në në Fushë Kosovë. Është shpjeguar ecuria e procedurës hetimore në rastet që trajton IPK-ja në përputhje me Kodin e Procedurës Penale, inspektimet dhe roli i tyre në ngritjen e profesionalizmit policor, si dhe rëndësinë e integritetit policor.



Takime të ngjashme janë realizuar në bashkëpunim me ICITAP-in dhe EVSB-në në Kuvendin e Komunës së Pejës, Prishtinës, në Prelluzhë, etj, ku kanë marrë pjesë përfaqësues të bashkësive lokale, fetare, shoqërisë civile, etj. DPBÇLI-ja ka mbajtur një ligjëratë edhe në Universitetin Publik të Mitrovicës “Isa Boletini”, ku kanë marrë pjesë studentë të shumtë. DPBÇLI ka qenë pjesë e disa takimeve të rregullta në KKSBB të Kuvendit Komunal - Prishtinë, Pejë, Kamenicë, Kaçanik, etj, ku janë diskutuar brengat e përfaqësuesve të komuniteteve.

d) Bashkëpunimi ndërkombëtar

IPK-ja çmon lartë bashkëpunimin me ICITAP-in, i cili është i rëndësishëm së veçantë. ICITAP ka ndihmuar IPK-në edhe këtë vit në zhvillimin e mëtejshëm të kapaciteteve profesionale dhe teknike. Trajnimet që ka ofruar ICITAP-i ndër vite, kanë qenë mëse të nevojshme për IPK-në dhe të duhura për të arritur përmbushjen e misionit të IPK-së. Gjatë këtij viti, IPK është përkrahur me trajnime specifike që kanë fuqizuar kapacitetet profesionale. Nga trajnimet kanë përfituar mbi 100 pjesëmarrës. Mbi 50 zyrtarë të IPK-së kanë ndjekur disa trajnime nga fusha e hetimeve nga ekspertët të Byrosë Federale të Hetimeve (FBI).

Programi i ICITAP-it këtë vit ka përkrahur IPK-në me trajnime edhe nga fusha e sigurisë kibernetike. Mbi 30 punonjës të IPK-së kanë ndjekur trajnimin “Ndërgjegjësimi për sigurinë kibernetike”. Këta zyrtarë kanë marrë informata shtesë rreth sigurisë kibernetike, mbrojtjes së të dhënave elektronike, mbrojtjes së fjalëkalimeve, etj.

Me mbështetjen e ICITAP-it dhe Ambasadës Amerikane në Kosovë, zyrtarë të IPK-së kanë zhvilluar një vizitë studimore në Teksas të SHBA-ve (San Antonio). Qëllimi i vizitës ka qenë shkëmbimi i përvojave në mes të institucioneve të dy vendeve në fushën e mbikëqyrjes policore, hetimeve penale dhe në veçanti luftën ndaj korrupsionit.

ICITAP-i u ka mundësuar katër (4) punonjësve të IPK-së që të jenë pjesëmarrës të Shkollës Policore dhe Komandës, të organizuar në Vushtrri nga ekspert dhe ligjërues të Northwestern University (Evanston-Chicago). Ky Program është i përvjetshëm dhe punonjësit e IPK-së kanë përfituar nga Universiteti i mirënjohur përgjatë tre muajve (prill-qershor 2019).

Përkrahja e ICITAP-it gjatë vitit 2019 zuri vend edhe me donacion në pajisje, siç ishte rasti me pajisjet për forenzikë. Në këtë mënyrë, historia e bashkëpunimit mes IPK-së dhe ICITAP-it, ka ndikuar që IPK në vazhdimësi të fuqizohet, qoftë në zhvillimin e resurseve njerëzore përmes trajnimeve profesionale, qoftë përmes pajisjeve për punë të pranuar si donacion.



Misioni i OSBE-së në Kosovë gjatë vitit 2019 ka ofruar përkrahje për IPK-në me trajnime të specializuara dhe me donacione të ndryshme. OSBE ka ofruar një donacion për IPK-në duke mbështetur projektin për rregullimin e kushteve teknike dhe të sigurisë për dhomën e dëshmimeve e cila mundëson që organizata të përmbushë standardet ndërkombëtare.

IPK-ja është përkrahur nga OSBE-ja edhe me trajnime të specializuara në fushën e hetimit të korrupsionit dhe fuqizimit të integritetit policor. 49 zyrtarë kanë ndjekur programin me katër module në temat: hetimi penal i parregullsive financiare dhe korrupsionit në radhët e policisë, trajtimi dhe mbrojtja e informatorëve dhe sinjalizuesve, analiza dhe vlerësimi i rrezikut për korrupsion në radhët e policisë dhe testimi i integritetit. Programi ka synuar të rrisë kapacitetet e IPK-së në ushtrimin efektiv të rolit mbikëqyrës. IPK është përkrahur edhe me trajnime në fushën e menaxhimit të hetimit financiar dhe abuzimit me financa publike.



OSBE ka përkrahur edhe Punëtorinë për Rishikimin e Planit Zhvillimor Strategjik të IPK-së 2019-2021, ku është diskutuar për realizimin e aktiviteteve dhe objektivave të parapara. Me mbështetjen e OSBE-së, një delegacion i IPK-së ka zhvilluar vizitë në Drejtorinë e Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Kroacisë. Qëllimi i vizitës ka qenë shkëmbimi i përvojave në mes dy institucioneve në fushën e mbikëqyrjes policore. Zyrtarët e IPK-së janë me procedurat e punës dhe reformat e ndërmarra nga Kroacia në këtë fushë.

Në kuadër të projektit “Avancimi i të drejtave të njeriut në Policinë e Kosovës”, të financuar nga Bashkimi Evropian dhe Këshilli i Evropës në kuadër të “Mekanizmit Horizontal për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë”, 17 zyrtarë të IPK-së janë certifikuar si trajnerë në fushën e të drejtave të njeriut pas trajnimit të organizuar për “Trajnimin e trajnerëve për të drejtat e njeriut dhe hetimi efektiv ndaj keqtrajttimeve”.

Përmjes modulit “Trajnimi për Trajnues”, projekti ka ndihmuar trajnimin e 17 trajnerëve në këtë fushë, të cilët kanë përfutur njohuri nga trajnerët më të mire vendor e evropian. Trajnimi ndihmoi në aftësimin e zyrtarëve të IPK-së për të zhvilluar trajnime të kësaj natyre, në mënyrë të pavarur, si dhe në pajisjen e tyre me njohuri praktike e teorike të nevojshme dhe të profilizuara në të drejtat e njeriut, si dhe hetimin efektiv të keqtrajttimeve.

Në kuadër të projektit të Këshillit të Evropës, IPK-ja është përkrahur me një videospot për “Linjën e kaltër” dhe në kuadër të kësaj nga DPBÇLI është përgatitur një skenar lidhur me përmbajtjen e tij. I njëjti është emetuar në dy gjuhë në Televizionin Publik (RTK 1 dhe RTK 2 nga data 8 prill deri më 31 maj 2019). Si pjesë e fushatës për Linjën e kaltër, DPBÇLI-ja ka shpërndarë dhe vendosur posterë në Pikat e Kalimit Kufitar (Vërmicë, Qafë e Prushit, etj).

IPK-ja në vitin 2019 ka marrë pjesë në Konferencën e radhës së EPAC-ut në Suedi. IPK-ja është përfaqësuar në mesin e 33 delegacioneve nga institucionet mbikëqyrëse policore, agjencitë evropiane kundër korrupsionit, si dhe përfaqësuesve nga EUROPOL, OLAF dhe organizatat të tjera ndërkombëtare e rajonale. Në Konferencë është trajtuar fuqizimi i luftës kundër korrupsionit, fuqizimi i integritetit policor, si dhe roli i sinjalizuesve në këtë drejtim. Përfaqësuesit e IPK-së kanë zhvilluar takime të ndara me shumicën e delegacioneve me qëllim të njohjes dhe shkëmbimit të praktikave të mira në forcimin e sundimit të ligjit.



IPK-ja përmes të DPBÇLI-së ka përgatitur Draft Marrëveshjen për bashkëpunim në fushën e mbikëqyrjes policore me Republikën e Maqedonisë së Veriut. Kjo marrëveshje ka për qëllim që të përmirësojë bashkëpunimin në fushën e shërbimeve të kontrollit të brendshëm në të dy vendet, me qëllim rritjen e efektivitetit të luftës kundër korrupsionit në radhët e policisë si dhe respektimin e të drejtave e lirive të individit. Në janar të vitit 2019, MPB e Republikës së Kosovës dhe ajo e Republikës së Maqedonisë së Veriut kanë nënshkruar Memorandumin për forcimin e bashkëpunimit në fushën e kontrollit të brendshëm.

Në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar, një delegacion i IPK-së ka realizuar një vizitë studimore në muajin shtator në Republikën e Kroacisë. Vizita u realizua me qëllim që të shkëmbehen përvojat në mes institucioneve në fushën e mbikëqyrjes policore, vendosjen e komunikimit të drejtpërdrejt, shkëmbimit të informacioneve dhe shqyrtimit të mundësisë së avancimit të bashkëpunimit dy palësh përmes arritjes së një marrëveshjeje bashkëpunimi.



IPK-ja ka marrë pjesë edhe në Konferencën e katërt të Njësive të Kontrollit të Brendshëm të Mbikëqyrjes Policore në Bullgari, nga data 4 deri 6 nëntor 2019, e cila është organizuar nga NERCISU (Rrjeti për Bashkëpunim të Zgjeruar Rajonal të Njësive të Sigurisë së Brendshme). Në Konferencë kanë marrë pjesë edhe përfaqësuesit homologë nga vendet e rajonit dhe më gjerë, si: Turqia, Greqia, Rumania, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, Serbia, etj. Konferenca ka pasur për qëllim shkëmbimin e përvojave të njësive në fushën e kontrollit të brendshëm dhe praktikave të luftimit të korrupsionit në shërbimet policore.

9. SHËRBIMET FINANCIARE, ADMINISTRATIVE DHE MBËSHTETËSE

Departamenti i Financave dhe Shërbimeve të Përgjithshme ka rol mbështetës dhe të rëndësishëm në menaxhimin e buxhetit, burimeve njerëzore, sistemeve të teknologjisë informative dhe shërbimeve logjistike në arritjen e objektivave të IPK-së.

Përgjegjësitë (detyrat) e Departamentit janë: menaxhon dhe mirëmban informatat për burimet njerëzore të IPK-së, asiston menaxhmentin në organizimin e brendshëm, ofron mbështetje administrative, logjistike dhe të shërbimeve të teknologjisë informative; siguron zbatimin e procedurave për përzgjedhjen dhe punësimin e personelit të kualifikuar, në përputhje me legjislacionin në fuqi; koordinon përgatitjen, zbatimin, raportimin dhe vlerësimin e buxhetit të IPK-së; koordinon zbatimin me kohë të detyrimeve financiare të IPK-së; menaxhon sistemin e arkivit dhe dokumentet e brendshme të IPK-së; ofron shërbime logjistike për IPK-në; mirëmban pajisjet e TI-së dhe ofron shërbime të TI-së.

Departamenti është i strukturuar në tre divizione

- Divizioni për Buxhet dhe Financa;
- Divizioni I Burimeve Njerëzore; dhe
- Divizioni për Teknologji Informative dhe Shërbime Logjistike.

Departamenti ka të punësuar 18 punonjës.

DEPARTAMENTI PËR FINANCA DHE SHËRBIME MBËSHTETËSE

Ofruam shërbime mbështetëse për funksionet operative të organizatës:

- Menaxhuam buxhetin e ndarë dhe realizuam **96.5%** të tij;
- Realizuam fazën e parë të projektit për digjitalizimin e Arkivit të organizatës;
- Realizuam Planin e dalur nga Strategjia e Trajnimeve të IPK-së, duke realizuar gjithsej **33** trajnime ku përfituan gjithsej **355** vijues;
- Realizuam projektin e Dhomës së dëshmive, falë përkrahjes ndërkombëtare.

Departamenti përmes divizionit përkatës ka përgatitur propozimet buxhetore, ka koordinuar çështjet buxhetore për të gjitha strukturat organizative të IPK-së, ka përcjellë dhe raportuar mbi ekzekutimin buxhetor, ka siguruar që shpenzimet financiare janë bërë në përputhje me rregullat dhe procedurat buxhetore, ka menaxhuar rezervat e parasë dhe ka siguruar se kontrolli i brendshëm financiar është i bazuar në parimet e llogaridhënies, etj.

Realizimi i buxhetit për vitin 2019 nëpër kategori ekonomike është paraqitur në tabelën vijuese. Vërehet se është arritur që buxheti i ndarë të shpenzohet në përqindje të lartë, brenda planifikimeve buxhetore, në masën prej 96.52%. Pagat dhe mëditjet marrin pjesë me 77.2% në strukturën e shpenzimeve buxhetore të IPK-së, mallrat dhe shërbimet me 19.97%, shpenzimet komunale me 0.26% dhe investimet kapitale me 2.57%.

Tabela nr. 9 - Pasqyra e buxhetit të ndarë dhe të shpenzuar sipas kategorive ekonomike (2019)			
Kategoria Ekonomike	Buxheti final	Realizimi	Përqindja (%)
Paga dhe Mëditje	1,012,482.77	1,012,482.77	100.00
Mallra dhe Shërbime	308,114.00	261,923.99	85.01
Shpenzime Komunale	3,500.00	3,431.80	98.05
Projekte Kapitale	34,778.00	33,738.50	97.01
Gjithsej	1,358,874.77	1,311,577.06	96.52

DFSHP-ja ka përfunduar fazën e parë të projektit kapital “Funksionalizimi dhe digjitalizimi i Arkivit të IPK-së” të planifikuar për këtë vit. Në kuadër të këtij projekti është bërë furnizimi dhe instalimi i sistemit modular që posedon mbylljen qendrore të secilit sistem dhe mundësinë e qasjes në sistem vetëm nga personat e autorizuar. Sistemi modular mundëson shfrytëzimin optimal të hapësirës, mbrojtjen e dokumenteve të arkivuara nga qasjet e paautorizuara, mbrojtje nga pluhuri dhe siguri ndaj zjarrit. Ky investim është financuar nga IPK-ja dhe konsiderohet projekt shumëvjeçar. Faza e dytë e projektit përfshin digjitalizimin e tërësishëm të arkivit ku të gjitha lëndët përveç formës fizike, do të ruhen edhe në atë elektronike, si dhe do të krijohet një bazë e avancuar e të dhënave për Arkivin.



Avancimet e TI-së në IPK janë bërë në hap me teknologjitë e fundit. Me këtë avancim, DFSHP-ja ka arritur të ngritë efikasitetin e punës së stafit, si dhe të bëjë përmirësimet e nevojshme në aspektin e sigurisë për të parandaluar kërcënimet e mundshme kibernetike.

Në bashkëpunim me zyrtarët nga Policia e Kosovës, është bërë instalimi dhe konfigurimi i nevojshëm për rrjetin e brendshëm të Policisë së Kosovës në objektin e IPK-së. Me këtë zyrtarëve të IPK-së do të iu mundësohet shfrytëzimi i sistemeve dhe bazave të të dhënave policore sipas mandatit dhe Marrëveshjes së Bashkëpunimit në mes të PK-së dhe IPK-së.

DFSHP ka krijuar dhe funksionalizuar sistemin elektronik të Transportit që shërben si data bazë. Ky sistem mundëson pasqyrimin e gjendjes së flotës së IPK-së në kohë reale dhe përmes tij bëhet edhe menaxhimi dhe kontrolli i vazhdueshëm, si dhe ndihmon në raportimin e saktë të shpenzimeve që kanë të bëjnë me flotën e automjeteve.

Sistemi SURS mundëson raportimin statistikor në kohë reale (real time) për DH-në dhe DMA-në. Në këtë sistem stafi i Divizionit të Teknologjisë Informative dhe Shërbimeve Logjistike i DFSHP-së është angazhuar që në bashkëpunim me zyrtarët nga MPB-ja të bëjë implementimin e tij për pjesën që shfrytëzohet nga IPK-ja.



Në muajin maj, IPK-ja ka mbajtur ceremoninë e përrimit të Dhomës së dëshmime, i realizuar si donacion i OSBE-së. Në ceremoni kanë marrë pjesë edhe përfaqësues të MPB-së dhe OSBE-së. Zëvendës Ambasadori i OSBE-së ka paraqitur qëndrimin për bashkëpunim të ndërsjellë për avancimin e punës në IPK. Projekti konsiderohet jetik për IPK-në dhe në përputhje me standardet e policive ndërkombëtare dhe standardet e Kodit Evropian të Etikës Policore.

Zhvillimi i vazhdueshëm profesional vazhdon të mbetet përkushtim i menaxhmentit, drejt mbajtjes së stafit në hap me zhvillimet dhe standardet. Bazuar në të dhënat e Divizionit të Burimeve Njerëzore, gjatë vitit 2019 janë organizuar 33 trajnime në fusha të ndryshme, bazuar në vlerësimin e nevojave trajnuese dhe planifikimin e trajnimeve bazuar në Strategjinë e Trajnimeve. Një numër kaq i madh i trajnimeve është arritur falë përkrahjes edhe të partnerëve vendor dhe ndërkombëtar. Në tabelat si në vijim pasqyrohen trajnimet e stafit operativ dhe atij administrativ të realizuara gjatë vitit 2019.

Tabela nr. 10 - Pasqyra e trajnimeve të organizuara për punonjësit operativ			
Nr.	Trajnimi	Organizator	Vijues
1	Hetimi penal i parregullsisve financiare dhe korrupsionit në PK	OSBE	12
2	Trajnimi i trajnerëve për të drejtat e njeriut dhe hetimin efektiv të keqtrajtimit	BE	14
3	Trajtimi dhe mbrojtja e informatorëve	OSBE	12
4	Analiza dhe vlerësimi i rrezikut të korrupsionit në PK	OSBE	12
5	Testi i integritetit	OSBE	12
6	Intervistimi dhe marrja në pyetje	ICITAP	25
7	Pastrimi i parave dhe kompetencat e zgjeruara të konfiskimit për hetues	BE	8
8	Të drejtat e njeriut, menaxhimi i ankesave kundër policisë dhe hetimi i rasteve të keqtrajtimit	BE	39
9	Shkolla Policore dhe e Komandës (Northwestern University)	ICITAP	4
10	Trajnimet e përgjithshme për zbatimin e Udhëzuesit dhe Doracakut të ri për hartimin e koncept dokumenteve	ZK	4
11	Trajnimi për zyrtarë informim dhe marrëdhënie me publikun	ICITAP	4
12	Hetimi i avancuar i korrupsionit dhe krimit të organizuar	ICITAP	29
13	Hetimet financiare	ICITAP	1
14	Hetimet e korrupsionit publik	ICITAP	1
15	Ndërgjegjësimi lidhur me rëndësinë e sigurisë kibernetike	ICITAP	33
16	Teknika e intervistimit	OSBE	21
17	Hetimi i abuzimit me financa publike	OSBE	20
18	Trajnimi për medie	OSBE	2
19	Menaxhimi i hetimeve komplekse financiare	OSBE	19
20	Kursi i ricertifikimit	IPK	52
21	Trajnimi i avancuar profesional për zyrtarë të prokurimit	IKAP-KRPP	1
Gjithsej			325

Tabela nr. 11 - Pasqyra e trajnimeve të organizuara për punonjësit administrativ mbështetës			
Nr.	Trajnimi	Organizator	Vijues
1	Trajnimi i trajnerëve për të drejtat e njeriut dhe hetimin efektiv të keqtrajtimit	BE	3
2	Menaxhimi i cilësisë në administratën publike	IKAP	2
3	Trajnimi për Microsoft Excel 2013	IKAP	2
4	Komunikimi, konfliktet dhe puna e ekipore	IKAP	1
5	Sistemi për menaxhimin dhe arkivimin e dokumenteve (SAMED)	IKAP	1
6	Të drejtat e njeriut, menaxhimi i ankesave kundër policisë dhe hetimi i rasteve të keqtrajtimit	BE	12
7	Integriteti gjatë menaxhimit të ekzekutimit	ICITAP	2
8	Dizajnimi dhe menaxhimi i politikave të integritetit evropian	IKAP	1
9	Organizimi dhe funksionimi i administratës shtetërore dhe agjencive të pavarura, marrëdhënia e punës, me theks të veçantë në Shërbimin Civil dhe pagat në sektorin publik sipas legjislacionit të ri	FLSA	2
10	Ndërgjegjësimi lidhur me rëndësinë e sigurisë kibernetike	ICITAP	2
11	Karta e të drejtave themelore të Bashkimit Evropian dhe Çështjet e Lirisë, Sigurisë dhe Drejtësisë	IKAP	1
12	Trajnimi i avancuar profesional për zyrtarë të prokurimit	IKAP-KRPP	1
13			
Gjithsej			30

